

GJERGJ XEXO
PËRJETËSISHT TË PANJOHUR
MBI SHQIPËRINË DHE SHQIPTARËT
ESE HISTORIKE

BOTIMET TOENA

GJERGJ XEXO

Përjetësisht të Panjohur

mbi Shqipërinë dhe shqiptarët

(Pjesa I)

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2015

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo
Redaktore: Nirvana Lazi
Korrektore letrare: Majlinda Bami
Përkujdesja grafike: Albana Kuraj Gega
Kopertina: Megi Xexo

ISBN 978-9928-205-25-4

© Autori dhe Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi i materialeve që përmban ky libër me asnjë mjet apo formë, as me fotokopje, as pjesërisht, pa lejen me shkrim të Botimeve Toena.

Botimet TOENA
Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë
Tel.: + 355 4 22 40 116; 22 58 893
Fax: +355 4 22 40 117
E-mail: redaksia@toena.com.al
botimet.toena@gmail.com
[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

Mendimi im i parë shkon drejt atyre që, sikundër dhe unë, duke mos qenë as historianë, as sociologë, as politologë, apo të tjerë ekonomistë - por të pakënaqur nga shpjegimet që kishin gjetur në libra, patën guximin një ditë të rebeloheshin me një pyetje më tepër - fatkeqësisht, pa pasur as kohë, as edhe mjete për t'u thelluar në kërkimin e përgjigjes.

Mendimi im i dytë shkon drejt gjithë të tjerëve që nuk kanë dyshuar asnjëherë mbi rrëfenjat që u kanë mësuar, me shpresë se leximi i faqeve që vijojnë do t'u zgjojë më në fund një pjesë të kuriozitetit - atë pjesë të vënë në gjumë nga të tjera lexime.

Përfundimisht, falënderimet e mia shkojnë drejt atyre që më dhanë kohën dhe që më mbështetën gjatë kërkimit të mjeteve.

Dy fjalë

1. Mendimi për ta shkruar këtë libër, më pati lindur që në verën e vitit 1997, në kohën e trazirave civile, kur vendi ishte zhytur në një anarki të papërshtatshme dhe, kështu, po fshinte nga llogaria e tij përvojën e brishtë demokratike.

Pas rënies së komunizmit dhe luzmimit të “boat people” shqiptar drejt vendeve fqinje, ishte hera e dytë që Perëndimi merrte mundimin ta hidhte vështrimin mbi këtë truall të dalë nga humbësira, përpara se të dërgonte trupat paqevënëse. Dy vjet më vonë, më 1999, u lajt një skenar disi tjetër: NATO-ja i jepte fund luftës së Kosovës me anë të një lufte ajrore dhe e zgjidhte fatin e refugjatëve kosovarë nëpërmjet ndërhyrjes me trupa. Përsëri dy vjet më vonë, më 2001, i erdhi radha Maqedonisë, që të dridhej për shkak të pakicës së saj shqiptare...

Ky ortek ngjarjesh që zotëronte vetinë për ta tronditur Ballkanin e tërë dhe për ta shqetësuar mbarë Europën, ngjalli diskutime të panumërta. I intrigoj shpirtat dhe i detyroi analistët të mprihnin lapsat. Për ta kuptuar se çfarë kërkonin këta shqiptarë, u ndeshën një varg pikëpamjesh, u zbërthyen një numër skenarësh, u zhvarrosën, madje dhe u shkruan rishtas, disa vepra “reference”¹. Përfundimisht, lexuesit dhe dëgjuesit zbuluan se “përrjashtimi shqiptar” nuk ishte gjë tjetër, veçse një frutë e çuditshme, e krijuar në një vend të shkretuar nga utopia, ku ndërkohë banorët bënë “rojat e Stalinit”, ndërsa shpërthimi i pashmangshëm i “pasioneve”, para së gjithash, e kishte origjinën në një logjikë të dëshpërimit.

Në rolin e një vëzhguesi të paanshëm, që ka privilegjin e të jetuarit të kësaj bote dhe luksin e të këqyrurit nga larg, mua si krijues, shpesh më përshkonte një ndjenjë e çuditshme: ajo që i bashkonte të gjitha këto analiza, ishte thjesht

1. Shih, sipas shfaqjes së tyre kronologjike në libraritë e Francës: Jean BERTOLINO - *Albanie, la sentinelle de Staline*. Editions Seuil, 1979; Elisabeth et Jean-Paul CHAMPSEIX - *L'Albanie ou la logique du désespoir*, La Découverte, Paris, 1992; Gabriel JANDOT - *L'Albanie d'Enver Hoxha (1944-1985)*, Paris, L'Harmattan, 1994; Sonia COMBE et Ivaylo DITCHEV (nën drejt.) - *Albanie utopie, huis clos dans les Balkans*. Éditions Autrement, collection Monde, 1996; Pierre CABANES, Bruno CABANES - *Passions Albanaïses, de Berisha au Kosovo*, Ed. Odile Jacob, Paris, 1999.

nevoja për të shpjeguar një fenomen shqetësues, me pasoja - të qena ose të paqena - lidhur me sigurinë e Europës. Ngutja, po aq e dukshme sa edhe mosnjohja e thellë e vendit dhe e njerëzve, rrëshqiste mbi sipërfaqen e sendeve dhe rikthente një imazh që interpretohej si një realitet i pagabueshëm. Çmontimi i së tashmes dhe analiza e pjesëve bëhej pa u thelluar në kuptimin e strukturës së të shkuarës, e cila mbetej rob i skemave të paracaktuara dhe të ngurta. Fytyra e vendit po skicohej pa mundur që të zotërohej dot bashkësia e fushave dhe e marrëdhënieve ekonomike, politike, sociale, njerëzore.

Pas zbulimit të trashëgimisë së lashtë dhe misterioze, si dhe të ashpërsisë të vendit dhe të njerëzve me fitimin e pavarësisë; pas konstatimit të varfërisë proverbiale dhe ekzotizmit oriental të monarkisë së Zogut; pas braktisjes të kokëfortësisë së pashembullt ideologjike të regjimit komunist, vendi kish humbur magjinë e tij të fundit - demokracinë piktoreske të Berishës - dhe u shndërrua në një rezervuar banal konfliktesh dhe emigrantësh. Ashtu si dhe herë të tjera, integrimi i shqiptarëve në një sistem vlerash shumëkombëshe përbënte aktin e parë të një drame të re: dramës së harresës dhe të indiferencës.

- Cila ishte pesha e së kaluarës në ndërtimin e së tashmes?
- Në ç'mënyrë elementet e së tashmes konkurronin në krijimin e modeleve të së ardhmes?
- Ç'përfaqësonte së fundi e kaluara dhe e tashmja në termat e identitetit shqiptar?

Ja, të gjitha këto ishin nxitje për t'u zhytur në ata dhjetëra libra, në ato qindra studime, në ata mijëra artikuj (pjesa më e madhe në frëngjisht dhe anglisht), për hir të një vendi të vogël prej 28.000 kilometrash katrorë, ku gjallonin tre milionë banorë. Ndërkohë ishte shfaqur një mafie e re shqiptare, që po tmerronte Europën; ishin ngritur shqetësime lidhur me të ardhmen e Kosovës...

Në vitin 2000 ideja fillestare që shndërruar në nevojë dhe kjo e fundit në një dëshirë të papërmbajtshme. Veçse kantieri paraqitej i pamasë dhe ndërkohë lajtmotivi ishte imponuar vetvetiu.

Në lidhje me këtë univers shqiptar, që merr format e një labirinti, nuk mund të merret guximi për të shtruar pyetje, qoftë edhe të thjeshta në pamje, pa pasur bindjen se përgjigjja mund ta tronditë dhe ta rrëzojë një ndërtesë të tërë të të menduarit, një sistem të tërë të ngritur mbi bazën e paragjykimëve ose të vrojtimeve të ngutura.

* * *

2. Pas një dhjetëvjeçari endjeje në këtë labirint, libri im gjeti formën, por u deshën edhe pesë vjet të tjerë që lënda të shndërrohej në përmbajtje dhe

masa e madhe e mendimeve dhe e fjalëve të ngjizej si brumi i arrirë që, duke u pjekur, jep bukën.

Sot, libri paraqitet përpara lexuesit me këtë arkitekturë të pazakontë:

- Një prelud - *Alkimia e vendit*
- 12 tablo vijuese - *Vallet e kohës*
- Një harmonikë popullore² - *Dilemat identitare*.

Edhe pse, në pamje të parë, forma duket e frymëzuar nga muzika baroke - vargu i valleve, temat kryesore janë strukturuar rreth Hapësirës - vend, Kohës - histori, Qenies - identitet. Pa dyshim, disa mijëvjeçarë ekzistence njerëzore në këto vise të diktojnë edhe peshën e tyre në lidhje me numrin e faqeve, ndërkohë që secila nga vallet sugjeron një periudhë - çelës në procesin e krijimit të shqiptarëve dhe të formimit të shtetit të tyre: antikiteti ilir dhe shartimi me kulturat greke e romake; çjerria administrative dhe fetare mes Romës Perëndimore dhe Bizantit Lindor; mesjeta e hershme dhe shfaqja e arbërve; ndeshja skënderbejase, bashkëjetesa me perandorinë e sulltanëve dhe islamizimi i shqiptarëve; më tej ngritja e çështjes kombëtare dhe, së fundi, lindja e shtetit të pavarur shqiptar.

Me kapërcimin e pragut të shek. XX, subjektet vijnë e bëhen edhe më të prekshme: Republika e Parë dhe monarkia e Zogut, lufta e përbotshme dhe fitorja e komunistëve, Republika e Dytë e Hoxhës, autarkia dhe shembja e regjimit, ardhja në pushtet e demokratëve dhe Republika e Tretë e Berishës, piramidat financiare dhe trazirat e vitit 1997, shkëlqimi dhe rënia e socialistëve të Nanos...

Filli kohor jep mundësinë që të dallohet përballja e përzetshme me fqinjët grabitqarë, me fuqitë kontinentale dhe me perandoritë planetare; të ndihet pesha e pushteteve konkurruese dhe e ideologjive zotëruese. Kronologjia konfliktuale zbulon ndeshjen e pamëshirshme mes Perëndimit dhe Lindjes, dyzimin mistik mes Krishtit dhe Muhamedit, përzgjedhjen e vështirë mes republikës dhe monarkisë, përgjakjen vëllavrasëse mes komunizmit dhe nacionalizmit, përpëlitjen hezituese mes demokracisë dhe anarkisë, fërgëllimën ndjellëse mes socializmit dhe biznesit. Regjistri shpirtëror dëshmon për luhatjen e vazhdueshme mes anonimatit dhe lavdisë, njëjtësimit dhe tjetërsimit, dashurisë dhe urrejtjes, kokëkrisjes dhe çmendurisë, dhimbjes dhe shpresës. Alkimia e vendit plotëson së fundi edhe formulën e krijimit të përbërësve njerëzorë të kombit: ilirë dhe arbër, gegë dhe toskë, fise luftarake të Veriut dhe bashkësi zanatqare të Jugut, bajraktarë kryelartë dhe bejlerë sipërmarrës, irredentistë kosovarë dhe çamë nostalgjikë, elitë qytetëse turko-file dhe intelektualë frankofonë.

2. Në italisht: *ciaccone*.

Dashur pa dashur, historia imponohet vetvetiu si çelës i çdo misteri, si një *sumum* njohjeje objektive dhe jashtëpersonale, meqenëse përfaqëson tretjen shumëshekullore të fateve individuale dhe të qëllimeve kolektive, pavarësisht se, me anë të saj, historianët shqiptarë të të gjitha kohërave kanë justifikuar *çka kanë dashur*. Sidoqoftë, ajo i shërben këtij libri vetëm si lëndë e parë, si një ind i dendur, i cili përmyll në strukturën e tij hermetike një varg pyetjesh të mbetura prej kohësh, pa përgjigje bindëse, të tilla si: *Nga vijnë shqiptarët? Përse pjesa më e madhe e tyre përqafoi fenë myslimane? Përse ishin të fundit që u shkëputën nga Perandoria Osmane? Përse e shkëmbyen republikën me monarkinë e Zogut? Si mundi një grusht komunistësh ta merrte pushtetin brenda tre vjetëve? Ç'do të thotë nacional-komunizmi i Hoxhës? Përse komunizmi mundi të rrënohej kaq thellë në vendin e shqiptarëve? Cilët janë përbërësit e përzierjes magjike, që e shndërron një kardiolog të zot në burrë shteti, një komunist model në babain e Demokracisë? Përse kosovarët ishin të fundit që e braktisën Jugosllavinë në agoni? Për ç'arsye shoqëria postkomuniste zgjodhi si mënyrë mbijetese ekonominë e nëndheshme të trafiqeve, të krimit të organizuar, të korrupsionit?*

Paralelisht përvijohet një galeri portretesh të atyre figurave të mëdha të historisë që vulosën epokat, patën ndikim të rëndësishëm në shndërrimin e vendit dhe prekën kujtimin e njerëzve - për të mirë dhe për të keq. Kështu, Skënderbeu dhe Ali Pasha i bëjnë thirrje qëndresës dhe bashkëjetesës, Abdyl Frashëri dhe Ismail Qemali përkujtojnë autonominë dhe pavarësinë, Ahmet Zogu dhe Fan Noli simbolizojnë monarkinë dhe republikën, Enver Hoxha e Ramiz Alia mishërojnë komunizmin dhe autarkinë. Së fundi, Sali Berisha dhe Fatos Nano materializojnë të tashmen, këtë përzierje anarkie dhe biznesi.

Për të gjitha këto, rrëfimi im, i ndërtuar në një formë jo të zakonshme, do ta tërheqë lexuesin. Megjithatë këtu dua të shtoj edhe dy arsye të tjera përse ky libër do të lexohet, madje besoj me mjaft kureshtje.

Së pari, me gjithë numrin e tyre në rritje lidhur me Shqipërinë dhe shqiptarët, repertori i veprave në gjuhë të huaj nuk ka mëkatuar kurrë nga bollëku, qoftë në shqip apo qoftë dhe në gjuhë të huaj. Arsyeja është fort e thjeshtë: pothuaj asnjëherë vendi s'i ka interesuar thellësisht interesat e diplomacisë europiane dhe, aq më pak, nuk ka bërë pjesë në ndonjë zonë kulturore të posaçme të kontinentit tonë. Edhe ata pak specialistë të huaj që janë qasur, u përkasin fushave të përafërta, që kanë të bëjnë me historinë ose gjeografinë e Ballkanit, me bizantologjinë ose artin mesjetar, që lidhen me gjuhësinë dhe arkeologjinë, ndërkohë që kohët e fundit, të tjerë gjeopoliticienë ose ekonomistë mundohen të ndriçojnë aspekte të veçanta të imponuara nga koniunkturat.

Për sa u përket autorëve vendas, me gjithë aftësitë e padiskutueshme, vështrimi i tyre i kryqëzuar ose vazhdon të tretet në traditën historiografike,

ose, në të kundërt, vijon të tërhiqet nga efektet e modës. Në qoftë se krenaria e të qenit shqiptar, sikundër dhe nacionalizmi, mundëson të thellohen aspekte të veçanta të historisë së vendit, duke u shndërruar në të njëjtën kohë në përsëritje të vazhdueshme të disa “të vërtetave”, njohja në përgjithësi mbetet rob i klisheve dhe i përfytyrimeve mitike. Por jo çdo gjë mund të identifikohet me historinë, as edhe me mitet, pasi instrumentet e tyre konceptuale janë të pamjaftueshme, qoftë edhe për t’iu përgjigjur pyetjes: Ç’përfaqëson identiteti shqiptar dhe në ç’mënyrë e gjen ai veten në identitetin evropian?

Për sa i përket modës, ajo çon drejt një “kulture të rezultatit”, pa qenë në gjendje të parashikojë dhe, aq më pak, të pranojë dështimin ose rezultatin “negativ”. Në këtë mënyrë, çdokush stigmatizon barrën e rëndë të pushtimit dhe të robërisë osmane, pa qenë në gjendje të këqyrë ndikimin e saj mbizotërues ndaj formimit të shoqërisë tradicionale; gjithkush mburr stabilitetin e projektit politik të monarkisë, pa u thelluar në dështimin e modelit të tij ekonomik; secili dënon dëmet ose krimet e komunizmit, pa mundur të vërë në dukje trashëgiminë e tij në marrëdhëniet qytetar-shtet; të gjithë theksojnë domosdoshmërinë e demokracisë, pa bërë lidhjen me shpërbërjen e vlerave njerëzore.

Rrallëherë, për të mos thënë kurrë, sintheza përqafton tërësinë e lëndës kohore për t’u vënë në shërbim të analizës së qenies shoqërore. Ende më rrallë instrumentet e kërkimit kanë mundur ta përqaftin gjenezën e etnisë me krijimin e shoqërisë njerëzore, ndërtimin e shtetit me strukturimin e fenomeneve sociale, politikën e klasave me arritjen e ekuilibrit ekonomik, kërkimin e aleancave të jashtme me efektet ndërsjellëse ndaj strukturave të brendshme, madhështinë jashtëkohore të Heroit me evolucionin shpirtëror të masave.

Ndoshta është me të vërtetë rasti që të tjerët, sikundër dhe vetë shqiptarët, por, në radhë të parë, këta të fundit, ta rizbulojnë vendin dhe Njeriun që banon në të, njerëzit sikundër dhe vendin që mbeten “përjetësisht të panjohur”.

Së dyti, apriori, në sytë e lexuesit të huaj objekti i këtij libri mbetet i kufizuar. Për këtë mjafton të këqyren përmasat e vendit dhe mungesa e peshës së tij ndërkombëtare. Veçse në këtë rast iluzioni i krijuar është jetëshkurtër, sepse, para së gjithash, ndodhemi në Ballkan.

Duke pasur parasysh mjedisin, temat e tejkalojnë vazhdimisht kuadrin lokal dhe trajtojnë një bashkësi njerëzore, një grumbull fati të përbashkët - bashkësinë ballkanike. Në të vërtetë, përpara shfaqjes së shtetit të pavarur, shqiptarët ishin subjekte osmane dhe ndanin një fat të përbashkët me serbët, grekët dhe të tjerë, bullgarë. Nga momenti që gjysma e trojeve u bë shqiptare e mirëfilltë, gjysma tjetër u shndërrua në serbe ose greke.

Në mënyrë të pashmangshme gjendemi në një logjikë konflikti: territore të diskutuara dhe të diskutueshme (Kosovë, Çamëri, Maqedoni Perëndimore), pakica irredentiste dhe luftëra të hapura ose të fshehura. Më tej, vendi

shket drejt kampit komunist dhe merr pjesë në një dinamikë të re: aleanca planetare dhe divorce pasionale (Jugosllavia, Bashkimi Sovjetik dhe Kina), antagonizma të papajtueshëm (Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Europa Perëndimore), që u shembën bashkë me Murin dhe e zunë përfund vetë regjimin. Që prej asaj kohe vendi u hap dhe dëshiroi Europën, ndërkohë që eksportoi masën e tij njerëzore dhe, bashkë me të, mafien e saj, si dhe rrjetat e trafikeve...

Duke përfunduar, shpreh bindjen se rajoni, kontinenti, madje edhe bota mbarë, të këqyrura nga dritarja Shqipëri përbëjnë një vështrim tjetër që i ofron lexuesit ky libër - **“Përjetësisht të panjohur”**.

Autori

(Tuluzë - Tiranë - Toronto, 2000-2015)

Përmbajtja

DY FJALË	7
----------------	---

1. PRELUD

ALKIMIA E VENDIT	19
-------------------------------	----

Ngjyrat e tokës	20
Farfuritjet e qiellit	26
Reflekset e ujit	28
Gjarpërimet e zjarrit	37
Vështrimi i tjetrit	45
Shënime për Preludin	52

2. VALLET E KOHËS

KOHA E PARË: Në terrin e antikitetit	61
---	----

Mes mitit dhe realitetit, nga tejlashtësia deri në vitin 285 e.s.

Të parët	63
Parailirët dhe ilirët nën optikën e albanologjisë	73
Parahistoria dhe etniciteti	77
Një kronologji e origjinës	89
Etniciteti i ilirëve	97
Ilirët dhe Iliria, të këqyrur nga bota antike	104
<i>Shënime për Kohën e Parë</i>	118

KOHA E DYTË: Nga një Romë në tjetrën	127
---	-----

Mes Perëndimit dhe lindjes, v. 285-1385

Koha e gjermanëve dhe e hunëve	128
Koha e sllavëve dhe e bullgarëve	135
Etniciteti i pasilirëve	142
Etniciteti i arbërve	158
Koha e latinëve dhe e arbrit	169
<i>Shënime për Kohën e Dytë</i>	184

KOHA E TRETË: Arbrit kundër Perandorisë Osmane	195
---	-----

Mes anonimatit dhe Lavdisë, v. 1385-1501

Koha e turqve osmanë	196
Heroi i legjendës	204

Burri i “shtetit” arbër.....	214
Çmimi i pavdekësisë.....	222
Barra e mitit.....	228
<i>Shënime për Kohën e Tretë</i>	237

KOHA E KATËRT: Shqiptarët në Perandorinë Osmane 244 Mes Krishtit dhe Muhamedit, v. 1501-1876

Rendi i ri osman	245
Nën shenjën e islamit	250
Vula e ndryshimit	272
Drejt autonomisë (së pashallarëve)	282
Fundi i një idili	297
Fqinjët që trokasën në portë	305
Shënime për Kohën e Katërt	318

KOHA E PESTË: Shqiptarët përballë çështjes kombëtare329 Mes njëjtësimit dhe tjetërsimit, v. 1876-1918.....

Zgjidhja e vonës së atdhetarizmit.....	330
Në grupin e fundit të besnikëve	346
Paradigmat e njëjtësimit të shqiptarëve/arnavutlar	362
Shqiptarizmi si esencë e nacionalizmit shqiptar	370
Lindja e vështirë e një shteti.....	384
Në honet e Luftës së Parë të Përbotshme	405
Shënime për Kohën e Pestë	413

KOHA E GJASHTË: Shqipëria përballë fqinjëve..... 430 Mes Republikës dhe monarkisë, v. 1918-1941

Shfaqja e një burri shteti	431
Në kërkim të formës dhe të përmbajtjes së shtetit	444
Republika e Parë e Zogut.....	463
Shqipëria e Zogut në mjedisin e saj ballkanik dhe mesdhetar	464
Lindja e një mbretërie	471
Vdekja e lajmëruar e mbretërisë	483
<i>Shënime për Kohën e Gjashtë</i>	498

Bibliografi e cituar..	513
------------------------------	-----

LISTA E FIGURAVE DHE ILUSTRIMEVE

Shqipëria - gjeografia fizike.....	31
Gjarpërimet e zjarrit.....	37
Rruga “Egnatia”	38
Sistemi i rrugëve antike në territorin shqiptar	39
Gjurmët kryesore të parahistorisë në Shqipëri.....	65
(paleoliti,neoliti, eneoliti dhe periudha e bronzit)	
Iliria dhe popujt e saj sipas përshkrimit të Apianit	75
Bota mesdhetare gjatë shekujve II – III e.s.	110
Ballkani romak në kohën e Justinianit I (527 - 565)	143
Mesdheu Lindor dhe Ballkani pas rënies së Bizantit (1216).....	173
Kufijtë e Sanxhakut të Arvanit-ilisë në vitin 1437.....	203
Shteti i Skënderbeut dhe Perandoria Osmane (1448 – 1468).....	217
Gjergj Kastrioti – Skënderbej (1405 – 1468)	233
Administrimi osman i territorit arbër	246
sanxhaqet në fillim të shekullit XVI	
Administrimi osman i territorit arbër	247
sanxhaqet në fillim të shekullit XVII	
Shpërndarja demografike e myslimanëve	256
sanxhaqet ballkanike - viti 1525	
Pashallëqet e Bushatllinjve dhe të Tepelenës (1812 – 1815)	289
Ali pashë Tepelena (1744 – 1822)	291
Principata e Serbisë para dhe pas Kongresit të Berlinit (1803 – 1913) 311.....	
Principata e Malit të Zi para dhe pas Kongresit të Berlinit (1788 – 1913)	315
Mbretëria greke para dhe pas Kongresit të Berlinit (1832 – 1913)	316
Abdyl bej Frashëri (1839 – 1892).....	335
Harta administrative e Ballkanit Perëndimor në vitin 1888	340
Katër vilajetet osmane (i Shkodrës, i Janinës, i Kosovës dhe i Manastirit)	
që përmbledhnin tërësinë e popullsisë shqiptare në Ballkan	
Shtetet e Ballkanit dhe Perandoria Osmane mes viteve 1888 - 1910	
350	
Ismail Qemal Vlora (1844 – 1919)	361
Shqipëria gjatë luftës ballkanike të vitit 1913	389
Kufijtë e Shqipërisë (nga viti 1913 deri në vitin 1925)	396
Esad pashë Toptani (1863 – 1920)	407
Ahmed Zogolli (1895 – 1961)	439
Theofan S. Noli (1882 – 1965)	453
Shqipëria e Zogut në mjedisin e saj ballkanik dhe mesdhetar	464
Shqipëria nën pushtimin italian (1941)	496

PRELUD

Alkimia e vendit

“E dua këtë vend të lartë pa ndërë nevojën as të jem krenar për të, as edhe të ndiej turp nga ai.”

Autori



endi, i cili në të folurën lokale quhet *Shqipëri* dhe i njohur ndryshe në mbarë botën si *Albania - Albanie*, ndodhet në Europën Jugperëndimore; më saktësisht, në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik¹ dhe laget nga deti Adriatik dhe Joni. Gjeografët e vendosin mes 39°38' dhe 42°39' të lartësisë gjeografike veriore dhe mes 19°16' dhe 21°4' të gjerësisë gjeografike lindore.

Në vijë ajrore, Shqipëria shtrihet nga veriu në jug në rreth 350 kilometra dhe nga lindja në perëndim në rreth 200 kilometra të tjerë: ndryshe, bëhet fjalë për 28.748 km², nga të cilët, 1.350 km² janë ujëra të brendshme - liqene dhe të tjerë lumenj.

“Small is beautiful” - është i njëjti vështrim i ëmbël sikundër ai i belgëve për Belgjikën e tyre të dashur (30.528 km²), ose i banorëve të Bostonit për Masaçusetsin e tyre të zemrës (27.337 km²).

Me fqinjët vendi ndan kufirin tokësor verior dhe një pjesë të atij lindor me përbërësit e vjetër të ish-Jugosllavisë (172 km me Malin e Zi, 115 me Kosovën dhe 151 me Maqedoninë) - gjithsej 438 km; më tej i mbështetet Greqisë me pjesën e tij jugore - 282 km kufij të përbashkët.²

E gjithë pjesa perëndimore laget nga deti, i cili krijon një breg prej 362 kilometrash - herë-herë ranor dhe herë-herë shkëmbor. Përtej detit shtrihet Italia, skaji më i afërt i së cilës gjendet 45 milje detare më tej - pra, ato 75 kilometrat e kanalit të Otrantos. I pykëzuar kështu mes botës latine, botës helene dhe asaj sllave, ky univers i vogël shqiptar ka mundur të ruajë gjithçka të vetën: gjuhën e veçantë, traditat dhe zakonet e tij, fetë e shumta... pra, fytyrën e vet të papërsëritshme.

Ngjyrat e tokës

Malor - kjo përshtypje e parë të vjen ndër mend, kur flitet për Shqipërinë, dhe ky imazh u mbetet në mendje vizitorëve tek e vrojtojnë nga dritarja vezake e avionit, sikundër dhe në mendjen e udhëtarëve që e kanë përshkuar më këmbë ose në kurriz të ndonjë kali apo mushke. Të tjerët që s'e kanë pasur këtë privilegj, mjafton të këqyrin atlasat ose tekstet e gjeografisë: më pak se një e treta (30%) e territorit gjendet nën 300 metra lartësi nga niveli i detit - fusha aluvionale perëndimore, si edhe pjesët e ulëta të luginave të lumenjve; një e tretë tjetër e madhe (41%) shtrihet ndërmjet 300 dhe 1.000 metrash lartësi - kodrina dhe kodra, pllaja të varura të të gjitha përmasave, si edhe shpatet e ulëta të maleve; e treta e fundit e vogël (29%) kulmon mbi 1.000 metra lartësi - shpatet e epërme të maleve, thepa të të gjitha formave dhe kulmet shkëmbore.³ Përfundimisht, me lartësinë e saj mesatare prej 708 metrash - mbi dy herë më e madhe se mesatarja e kontinentit - Shqipëria renditet në grupin e kreut të vendeve europiane, të udhëhequra nga Zvicra dhe fqinjët e saj të afërt, Mali i Zi dhe Maqedonia.

Kështu, që në fillim është dhënë tonaliteti dhe akordi themelor i lajtmotivit të vendit: kush përmend malet dhe relievin e lartë, ka parasysh vështirësinë e komunikimit, izolimin njerëzor dhe thyerjen shoqërore. Nga ana tjetër, në lidhje me një shoqëri e cila, tradicionalisht, ka mundur të mbijetojë falë kafshërritjes dhe bujqësisë, një terren i tillë përcakton kushte mjaft të veçanta: pak toka buke, parcela me përmasa të vogla, terrene me përbërje dhe struktura të ndryshueshme, pjerrtësia e të cilave e kufizon ndjeshëm ndërhyrjen e njeriut... Asgjë e habitshme, pra, nëse rritja e kafshëve mbizotëron në një bujqësi të orientuar drejt kulturave tradicionale, nëse rendimentet janë të ulëta, nëse pemërritja u paraprin sektorëve të tjerë në zonat e brendshme të vendit, ndërkohë që kulturat e kopshtit dhe perimet mbizotërojnë në fushë, në atë aq të lakmuarën ultësirë bregdetare.

Ultësira me origjinë aluvionale, e cila ndjek bregun e detit, mbledh dhe grumbullon ujërat sezonale; megjithatë, ajo mbetet e keqjujtur dhe, sipas stinëve, ose vuan nga thatësira, ose nga përmytjet. Tokat e punueshme që e përbëjnë, janë në përgjithësi të një cilësie të mesme dhe asnjëherë nuk kanë mundur të ngjiten në nivelet e dëshiruara. Me gjithë lehtësitë e kalimit që ofron, aq të zakonshme për një ultësirë, ajo nuk është aq mikpritëse sa mund të besohet - mjafton të çohen nëpër mend kënetat e panumërta të dikurshme, reja e mushkonjave, sikundër dhe malaria...

Cilësia e tokave përmirësohet në mënyrë të ndjeshme, duke u ngjitur luginave të ngushta të lumenjve: Drin, Mat, Shkumbin. Kjo cilësi rritet në pellgjet e brendshme, siç është rajoni i liqeneve të Ohrit dhe atyre të Prespës, "fusha" e Peshkopisë ose pllaja e Korçës, gjithmonë të rrethqarkuara

nga malet. Megjithatë njeriu nuk i ka reshtur asnjëherë përpjekjet për t'i rivlerësuar - nëpërmjet punës së tij - kodrat e ulëta ose të mesme, që e ndajnë ultësirën perëndimore nga masivet e brendshme malore. Në të vërtetë, nuk ka pasur zgjidhje tjetër, pasi sipërfaqja bujqësore është e kufizuar (nën 40% e sipërfaqes së përgjithshme) dhe vetëm gjysma e saj është e punuar (20% e sipërfaqes së vendit). Nga kjo e fundit, dy të tretat gjenden në zonën kodrinore: kodrinat e ulëta me toka terrigjene janë vënë nën kulturën e drithërave, ndërsa kodrat gëlqerore me shpate të pjerrëta dhe me trashësi të cekët të shtresës së dobishme shërbejnë kryesisht për pemët frutore. Të gjitha këto mjedise kërkojnë një mbrojtje të veçantë përballë gërryerjes së theksuar natyrore, gjë që e justifikon ngritjen sistematike të tarracave (30% e terrenit ndodhet në shpat).

Nga pikëpamja thjesht gjeofizike-tektonike, vendi - i mbiquajtur *Albanide* - është pjesë përbërëse e brezit orogjenik Dinaride - Albanide - Helenide, me pikënisje Alpet e Jugut dhe pikëmbërritje zonën e Antalias (veriperëndim i Turqisë) me shtrirje në Ballkanin Perëndimor. Vetë Albanidet konsiderohen si të përbëra nga dy njësi të gjera strukturore: Albanidet e brendshme, të karakterizuara nga një magnetizëm mjaft i zhvilluar dhe një tektonikë e vrullshme, si dhe Albanidet e jashtme që, ndonëse nuk njohin fenomene të tilla magnetike, gjenden nën trysninë e zonave tektonike dhe të brezave rrethues.⁴

Nën një këndvështrim tjetër të përgjithshëm fiziko-gjeografik, vendi mund të përfaqësohet i ndarë në katër zona të mëdha: Veriu malor, masivi qendror, rajoni malor jugor dhe ultësira perëndimore.⁵

- **Veriu malor** (rreth 10% e territorit), ky grumbull mbresëlënës malesh gri - Alpet shqiptare - kryesisht me përmbajtje gëlqerore-karbonatike, me ndërfaqe shtresash terrigjene ose magmatike, sikundër është rasti i malësisë së Gashit apo asaj të Vermoshit, mund të konsiderohet si vazhdim i Alpeve Dinarike dhe, më saktësisht, i rrafshnaltës malazeze. Edhe më të thepisura sesa pjesa tjetër e kësaj rrafshnalte, masivet malore kulmojnë në qendrën e tyre me majën e Radohimës (2.570 m), si dhe me majën e Jezercës (2.694 m) dhe bien drejt periferisë. Thellësisht të gërryerat nga aktiviteti i akullnajave kuaternare, në dimër ato grumbullojnë sasi të mëdha bore dhe akulli, të cilat shndërrohen në rezerva të mëdha uji. Lumenjtë e pakët, që e përshkojnë këtë masiv siç janë: Shala ose Valbona, transportojnë sasi të mëdha uji në pranverë apo gjatë verës përgjatë luginave të tyre të ngushta.

Në kontrast të thellë me lakuriqësinë gri të shkëmbit, shpati perëndimor i këtij masivi është i pyllëzuar dhe përbën parkun natyror pyjor të Thethit (2.600 hektarë që gjenden ndërmjet 750 dhe 2.570 metrash lartësi, prej të cilave rreth 1.700 ha janë pyll ahë dhe pishë), të ngritur në luginë e një akullnaje të vjetër. Në krahun e tij lindor gjendet parku kombëtar i luginës së

Valbonës (8.000 ha), i cili kufizohet në pjesën veriore me rezervën natyrore *strikte*⁶ të lumit të Gashit - 3.000 hektarë rreth një lugine të ngushtë, faqet e saj të pjerrëta janë veshur me pyje dushku, ahu dhe halorësh. Përfaqësuesit e faunës së Alpeve janë dhitë dhe kaprojtë e egër, shqipja dhe kali i qyqes, sikundër edhe ariu i murrmë, ujku dhe rrëqebulli.

- **Masivi qendror** (rreth 45% e territorit kombëtar) përbëhet nga një varg i vazhdueshëm ngritjesh malore pak a shumë të rrumbullta, sikundër edhe maja apo shpate herë-herë të ashpra, të organizuara në dy vargje të dallueshme: *vargu lindor*, i cili përfshin masivet e Tropojës, të Kukësit, Lurës, Bulqizës, Shebenikut, si dhe *vargu perëndimor* me masivet e Krrabit, të Tërbunit, Gomsiqes, Kashnjetit, Skënderbeut, Kuturumanit, Shpatit, Devollit dhe Moravës, që fillojnë dhe përfundojnë përtej kufijve shtetërorë, në Kosovë, Maqedoni ose në Greqi.

Këtu mbizotërojnë peridotitet dhe olivinitet, të shndërruara në gabro ose, më tej, në serpentinite - një formë e silikatit të magnezit, e cila ndodhet në shkëmbinjtë metamorfikë me ngjyrë të gjelbër të thellë, shpesh të këmbyer me gëlqerorë dhe me shkëmbin magmatik. Të gjitha pasuritë nëntokësore metalifere të Shqipërisë gjenden në këtë masiv qendror: vendburime të bakrit ose të piritit, të shoqëruara me pak ar dhe argjend; vendburime të kromit, të hekurit apo vendburimet e nikelit të shoqëruara me kobalt. Ky masiv prek gjithë rajonin lindor të vendit, duke u shtrirë nga rrëza e Alpeve të Veriut deri në kufirin grek, në jug të Korçës, dhe vijon me masivin e Pindit. Pjesa e tij më e ashpër ndodhet në veri: mes Drinit të bashkuar dhe Matit shtrihet krahina e Mirditës, tokë e gjelbër dhe pyll i dendur, gjithashtu i gjelbër - rezervuari kryesor i mineraleve të bakrit; më në jug, mes Drinit të Zi, Matit dhe Shkumbinit, është krahina e Bulqizës dhe ajo e Martaneshit, që kulmon në 1.873 metra me Kaptinën e Martaneshit. Në vijim trulli errësohet edhe më tepër - ndodhemi në mbretërinë e kromit dhe të derivateve të tij, me Bulqizën, kompleksin më të madh minerar të vendit. Në rrëzë të kësaj pjese të masivit - nga të dyja anët e Shkumbinit - gjenden krahina të tëra: Çermenika, Shpati dhe Polisi, me një lartësi të mesme dhe me disa maja të rralla mbi nivelin e 2.000 metrave.

Në këtë zonë gjarpëron e famshmja vijë sizmike e vendit, i cili herë pas here është shkundur rëndë nga dridhjet e nëndheshme. Në pjesën e sipërme ujëmbledhëse të lumit Shkumbin toka bëhet e kuqe në vishnje: mes Shebenikut në veri dhe fundosjes së Mokrës në jug, me atë gresin e tij të butë argjiloranor, duke kaluar nëpër Gurin e Kuq, ndodhemi në parajsën e hekurit dhe të mineraleve të tij, shpesh të shfrytëzuara në sipërfaqe. Edhe më në jug, të prera nga luginat e thella të gërryera në flysh, shtrihen krahina të tjera si: Opari dhe Gora, që kulmojnë me majën e Lenies (2.373 m) dhe atë të Ostrovicës (2.379 m). Këtu masivi i serpentinave dhe i gëlqerorëve këmbëhet me tarracat

e ngushta lumore, të cilat ngrihen shkallë-shkallë drejt pellgut të Pogradecit, ku mbizotërojnë argjilat e verdha ranore, më tej shkojnë drejt pllajës në gres dhe molasë të Korçës dhe Devollit,⁷ toka e të cilave përmban argjila të kuqe ranore të ardhura nga erozioni i strukturave kodrinore rrethuese të përbëra nga molasa, sikundër edhe depozita të errëta aluvionale dhe lakustre, mbetje të liqenit të dikurshëm të Maliqit. Pjesën më jugore të këtij masivi e përbën vargu me përmbajtje ofiolitike-gëlqerore: Mali i Thatë - Moravë - Gramoz, me majën e Gramozit (2.523 m), vend i shquar i shtegtimt të bagëtisë, i cili, me hijen e tij, mbron gropën e Kolonjës.

Pyllëzimi i masivit qendror mbetet mjaft i rëndësishëm, me gjithë shfrytëzimin e tij të shfrenuar gjatë viteve të fundit. Ky masiv strehon edhe pjesën më të madhe të parqeve kombëtare natyrore dhe zonave të mbrojtura të vendit siç janë: parku kombëtar në Lurë (një kombinim origjinal i një masivi pyjor prej 1.300 hektarësh që shtrihen nga 900 deri në 2.000 metra lartësi, si dhe i 13 liqeneve me natyrë karstike); parku kombëtar i Qafë-Shtamës rreth 25 km në lindje të Krujës (2.000 hektarë të pyllëzuar me pisha me burime të shumta uji); parku kombëtar i Dajtit (2.200 hektarë në fillimet e tij në vitet '60 të shek. XX, të cilët sot janë bërë rreth 30.000, të pyllëzuara me makje mesdhetare, me dushkajë dhe ah, që ngjiten deri në 1.612 metra lartësi); parku kombëtar i Bozdovecit - *Bredhi i Drenovës* (1.400 hektarë, prej të cilëve 750 janë të pyllëzuar me ah, bredh dhe lajthi aty në lartësinë mes 1.200 dhe 1.800 metrave); parku kombëtar i Shebenik-Jabllanicës¹ (rreth 34.000 ha në kufi me Maqedoninë, ku mbizotëron ahu, bredhi i bardhë dhe mështekna). Përfaqësuesit më të spikatur dhe më të mbrojtur të faunës mbeten gëtarët e mëdhenj: ariu i murrmë, derri i egër dhe ujku, sikundër dhe rrëqebulli dhe macja e egër. Në lindje të masivit qendror ndodhen malet më të larta të vendit: Korabi (2.750 metra) dhe sivëllai i tij, Koritniku (2.395 metra), rreth tyre gjendet rezervati natyror i Korab-Koritnikut - 26.500 hektarë të mbrojtur, me vlera të veçanta ekologjike. Grumbulli ku bëjnë pjesë këto male, shtrihet thellë në brendësi të Kosovës dhe mbetet një nga relievet më të thepisura dhe më të pashkelura të të gjithë Gadishullit Ballkanik.

- **Rajoni malor jugor** (rreth 20% e territorit), ky rajon ka një përbërje gjeologjike pak a shumë të thjeshtë: shkëmb gëlqeror ose dolomitik, i përshkuar nga breza flyshi dhe shtresa terrigjene. Relievi paraqet forma deri diku të rregullta: një vazhdimësi vargësh malore pak të thepisura dhe luginash pjellore. Në verilindje të Vlorës shtrihet zona e Mallakastrës me lartësi të vogël deri të mesme, e cila kulmon me Shpiragun në 1.200 metra. Dy vargjet malore kryesore, Trebeshinë - Dhëmbel - Nemërçkë dhe Gribë - Mali

¹ Park Kombëtar prej vitit 2008.

i Gjerë - Shtagarë janë orientuar sipas drejtimit veriperëndim - juglindje, dhe ndahen ndërmjet tyre nga shtrati i lumit Vjosë, si dhe shtrati i Drinos (Dropull). Këto grupmale përbëjnë edhe zgjatimin verior të masivit grek të Zagorionit, po ai që rrethon qytetin e Janinës. Edhe më në perëndim, duke ndjekur bregdetin e Jonit, shtrihet rrafshi i Kurveleshit me majën e Çikës (2.050 metra) përballë detit. Bardhësia e këtyre maleve, të gërryera nga erërat e detit, këmbët e të cilave njomen nga ujërat joniane, duke krijuar gjire dhe plazhe zhavorri me një bukuri të pakrahasueshme, kontraston me blunë e thellë që s'ka njohur kurrë ndotje. Struktura gëlqerore-dolomitike e shkëmbit lejon të kuptohet edhe natyrën e pasurive minerare, që gjenden në të: fosfatet alternohen me boksitet në gjithë zonën e Gjirokastrës deri në Kurvelesh, ndërsa në kategorinë e fosileve, qymyri i gurit të Memaliajt mbetet i vetmi konkurrent i denjë ndaj gazit dhe naftës së Mallakastrës.

Në skajin e sipërm të këtij rajoni - në shpatin perëndimor të malit të Tomorit (2,416 metra) shtrihet parku natyror homonim - rreth 24.700 hektarë me ah, pishë të zezë dhe rrobull. Disa dhjetëra kilometra më në jug gjendet parku natyror i Bredhit të Hotovës (me një sipërfaqe rreth 34.400 ha pranë fshatit Frashër të Përmetit ku, krahas bredhit, haset dushku dhe makjet). Në shpatin perëndimor të Malit të Gjerë ndodhet rezerva *strikte* natyrore e Kardhiqit - 1.800 hektarë shpate të thyera dhe shkëmbinj të thepisur të pyllëzuar kryesisht me dushk, me bredh maqedonas, panjë dhe bli. Disa dhjetëra kilometra më në perëndim, në lartësinë e malit të Çikës, ndodhet parku natyror i Llogorasë (rreth 1.000 hektarë pyll pishe, rrobulli dhe qiparisi, të përhapura nga 500 metra deri në 2.000 metra lartësi); në krah të tij, në gadishullin e Karaburunit, aty ku ndahet Adriatiku me Jonin, kohët e fundit është krijuar një park i ri kombëtar detar me sipërfaqe prej 12.500 hektarësh, nga të cilët rreth 10.000 hektarë në ujërat bregdetare.

Bregdeti jonian shtrihet nga skaji i gadishullit të Karaburunit që mbyll gjirin e Vlorës, deri në jug të qytetit të Sarandës, përgjatë tetëdhjetë kilometrash. Në pjesën më të madhe kjo rivierë e vogël, e cila bashkon malin e lartë dhe detin, është e tarracuar dhe kultivon ullirin dhe agrumet; i vetmi bemol në këtë polifoni tipike mesdhetare është mungesa e rrugëve të mira. Në pjesën më jugore të vendit shtrihet një fushë e vogël dhe pjellore aluvionale, që shkon poshtë Delvinës në Konispol, një pjesë e së cilës - mes Vurgut dhe Vrinës - është zënë nga liqeni i Butrintit, një liqen lagunor prej 1.600 hektarësh, përzierje e çuditshme e ujit të ëmbël dhe të kripur në fazë të zhvilluar eutrofikimi,⁸ i cili përbën edhe zonën më të madhe të rritjes së midhjeve të vendit. Rreth e qark tij shtrihet parku natyror i Butrintit me sipërfaqe 9.500 hektarë të pyllëzuar me ilqe, verr, vidh dhe frashër.

- **Ultësira perëndimore**, kjo pjesë e vendit përbën një rrip bregdetar që shtrihet prej liqenit të Shkodrës deri në afërsi të qytetit të Vlorës dhe

përfaqëson vetëm një të katërtën e sipërfaqes territoriale kombëtare. Në mesatare, ajo zgjerohet deri në 20-30 km në brendësi të tokës, përveç zonës së Elbasanit në qendër të Shqipërisë, ku arrin shtrirjen më të madhe prej 50 kilometrash. Në të vërtetë, bëhet fjalë për një ndërftutje të ultësirave aluvionale dhe të vargjeve kodrinore, ku toka në ngjyrë gri-kafe është e mbuluar me një bimësi tipike mesdhetare të përbërë nga dushkaja, shqopa, mërsina, gjineshtra dhe maré. Të gjitha pasuritë minerare të kësaj zone janë me natyrë fosile, në përputhje me morfologjinë e terrenit: linjitet e Valiasit alternohen me qymyrin e gurit të Kërrabës, ndërkohë që nafta bruto e Kuçovës ose e Patosit apo edhe gazi natyror i Ballshit ia le vendin bitumit të Selenicës.

Pranë bregut të detit, vetëm disa dhjetëvjeçarë më parë,⁹ thuajse në të gjithë shtrirjen e saj, kjo ultësirë ishte e mbuluar vende-vende me pellgje uji të ëmbël ose të kripur, të krijuara qoftë nga përmytjet e lumenjve, qoftë dhe nga vërshimet e detit. Nga veriu në jug dikur shtriheshin kënetat të tëra si: kënetat e Velipojës në rrjedhjen e Bunës, kënetat e Kakarriqit dhe e Zadrimes (2.400 hektarë) mes Shkodrës dhe Lezhës, në rrjedhjen e mesme të lumit të Dajçit; kënetat e Thumanës pranë Mamurrasit dhe ajo e Bregut të Matës (3.200 hektarë); kënetat e Durrës-Shkozetit (3.400 hektarë); e Tërbufit në Myzeqe pranë Lushnjës dhe, së fundi, kënetat e Vurgut - Vrinës pranë Sarandës. Pjesa dërmuese e këtyre kënetave nuk ekziston më, pasi janë tharë dhe drenuar, duke u shndërruar në toka të shfrytëzueshme bujqësore (gjatë viteve 1946-1976 u përfituan 250.000 hektarë). Por aksioni njerëzor, shpeshherë i orientuar prej qëllimeve politike, nuk ka mundur të gjejë përherë zgjidhje të drejta apo me interes nga pikëpamja ekonomike, sepse, jo gjithmonë, ka ditur ta respektojë mjedisin natyror. Tokat e përfituara në këtë mënyrë shpesh vuajnë nga një shkallë e madhe kripshmërie, siç është rasti i tokave të bardha të Durrësit, ose nga një nivel tepër i lartë lagështie, siç është rasti i tokave të murrme gati të zeza të Myzeqesë.

Shtrirjet ujore ekzistuese në bregdet janë pellgje gjysmë të ëmbla (ose gjysmë të kripura) - lagunat dhe zonat e lagështa. Kështu, në pjesën veriore të zonës bregdetare, pranë kufirit malazez, shtrihet pellgu i Bunë-Velipojës, një peizazh i mbrojtur prej 23.000 hektarësh, në përbërje të të cilit gjendet grykëderdhja e Bunës, kënetat e Domnit dhe laguna e vogël e Vilunit; 10 kilometra më në jug, në të dyja anët e grykëderdhjes së vjetër të Drinit, është pellgu i Kune-Vain-Merxhan-Tales, tashmë park natyror me rreth 4.400 hektarë kënetorë pjesërisht të pyllëzuar, ngjitur me të, në bregun e majtë të grykëderdhjes së lumit të Matit, shtrihet parku natyror i Patok-Fushëkuqes prej 5.500 hektarësh. Këto mjedise të mbrojtura luajnë një rol të veçantë në ciklin e riprodhimit dhe të dimërimit për një varg llojesh të mbrojtura të shpendëve të ujit dhe të peshkut.

Më në jug, përtej Kepit të Lagjit (Kalaja e Turrës) ndodhet parku kombëtar i Divjakë-Karavastasë, i ngritur rreth lagunës me të njëjtin emër, që zë një sipërfaqe të përgjithshme prej 43 km² (4.300 hektarë). Vetë parku përfaqëson 22.300 hektarë të pyllëzuar nga pishat ombrellë të detit dhe dëllinja kokërrmadhe, mes grykëderdhjes së lumit Shkumbin dhe Semanit dhe shërben si mjedis natyror i një vargu përfaqësuesish të faunës mesdhetare si: çakalli, iriqi, baldosa dhe fazani. Rreth 30 kilometra më në jug, në bregun e majtë të grykëderdhjes së Vjosës, shtrihet peizazhi i mbrojtur Vjosë-Nartë, një pellg prej 19.300 hektarësh, në skaj të tij gjendet laguna e Nartës - një sipërfaqe ujore prej 4.200 hektarësh nga të cilat 2.800 hektarë kripore, një mjedis fort i përshtatshëm për riprodhimin dhe dimërimin e një vargu shpezësh të mëdha ujore si pelikani kaçurrel ose flamengot.¹⁰ Të gjitha këto ekosisteme ujore bregdetare komunikojnë nëpërmjet kanaleve natyrore me detin Adriatik dhe pikërisht ky shkëmbim i vazhdueshëm mase e mbron faunën dhe florën ujore nga eutrofia, tendencat e së cilës janë të dukshme në disa prej tyre (Karavasta, Nartë). Ky eutrofizëm ndihmohet qoftë nga faktorët natyrorë: cektësia e lagunave, lartësia e pakët e baticave në detin Adriatik, regjimi i temperaturave të larta gjatë verës, po ashtu edhe nga faktori njerëzor: investimet e pamjaftueshme për mirëmbajtjen e kanaleve komunikuese, ndotjet me nitrare dhe fosfate të sjella nga ujërat sipërfaqësore, si dhe nga procesi i vrullshëm i urbanizimit dhe i turizmit, që prek rrethinat e tyre.

I gjithë bregdeti perëndimor i Shqipërisë mbulohet nga plazhe të gjata ranore, më të përmendurit janë: plazhi i Velipojës dhe ai i Shëngjinit me rërë të trashë të errët thuajse të zezë; si edhe plazhet e Lalzit, Durrësit, Kavajës, Divjakës dhe Vlorës me rërë të imët - të bardhë-gri në të artë. Bregdeti adriatik ka edhe portet më të rëndësishme të vendit pranë qyteteve: Durrës, Vlorë, Shëngjin. Më në brendësi, ligatinat (terrenet moçalore) ua lëshojnë vendin sipërfaqeve me cilësi të mesme, ku argjila dhe okra e verdhë këmbehen me sedimentet gurishtore. Vetëm ende më në thellësi, aty ku kodrat e ulëta fillojnë dhe ngrihen në këmbët e maleve të para, aty ku reshjet fillojnë dhe bëhen më të rregullta dhe rreziku i përmbytjeve zvogëlohet, cilësia e tokës nis të ngrihet dhe kthehet në vegjetale e pasurohet në humus.

Farfuritjet e qiellit

Klimën e vendit, krahas cilësorit “*malor*”, pa dyshim, e karakterizon epiteti “*mesdhetar*”. Vetë fakti se ndodhet bash në gjerësinë gjeografike 40°C të gjysmësferës veriore dhe, në radhë të parë, prania e gjithëgjendur e bregdetit të lagur nga ujërat e Adriatikut dhe detit Jon, bën që klima të pasqyrojë efektet,

ndërsa relievi të përcaktojë shkallëzimet: mesdhetare fushore, mesdhetare kodrinore, mesdhetare paramalore, mesdhetare malore.¹¹

Përfundimisht, ndikimi i kryqëzuar i pranisë së detit dhe i masës së maleve dhe rrafshnaltave të prapatokës ballkanike pjesëmerr në krijimin e gradientëve termikë dhe pluviometrikë tepër të lartë, gjë që shprehet në terren me një numër i madh mikrozonash dhe rajonesh klimatike, ndoshta me tepriçë, në krahasim me madhësinë e tij. Klima tipike mesdhetare e bregdetit (dimër i butë dhe i lagësht, verë e nxehtë dhe e thatë) kthehet në klimë pothuaj kontinentale në brezin lindor (dimër i ftohtë dhe verë e freskët) dhe alpin në pjesën skajore të Veriut (dimër i gjatë dhe i akullt, verë e shkurtër pothuaj e ftohtë).

Sidoqoftë, në rang vendi, vlerat mesatare termike mbeten relativisht të larta: temperatura mesatare vjetore është $+7,5^{\circ}\text{C}$ në veri dhe $+18^{\circ}\text{C}$ mbi bregdetin jonian. Në janar - muaji më i ftohtë i vitit, mesatarja e temperaturave shkon diku rreth -3°C në pjesën veriore dhe rreth $+10^{\circ}\text{C}$ në bregdet, ndërsa në muajin më të nxehtë - në korrik, këto vlera mesatare janë përkatësisht: $+16^{\circ}\text{C}$ dhe $+25^{\circ}\text{C}$. Në të kundërt, temperaturat e skajshme janë tepër të larta: maksimumi absolut shkon rreth $+40^{\circ}$ në rajonet qendrore (Burrel) dhe e tejkalon vlerën e $+44^{\circ}\text{C}$ në ultësi (Kuçovë), kurse minimumi absolut i vrojtuar është -26°C në Korçë dhe vetëm -5°C në Sarandë.¹²

Në qoftë se temperaturat e ulëta të dimrit në masivet malore dhe në pllajtat e vendit shkaktohen nga ndërfaqja e masave të ajrit të ftohtë me origjinë kontinentale, që mbizotërojnë motin e Ballkanit dhe të Europës Lindore në këtë periudhë të vitit, luhatjet termike ditore në brendësi të vendit janë kryesisht funksion i lartësisë së terrenit, si edhe të gradientit të temperaturës së krijuar mes tokës dhe detit të afërt. Për sa u përket krahinave jugore, ato mbeten thellësisht të ndikuara nga aktiviteti ciklonik i Mesdheut Jugor, i cili sjell masa ajri me origjinë tropikale ose subtropikale. Kjo gjë e shpjegon edhe faktin që viset tona janë të karakterizuara nga kontraste tepër të forta temperaturash, ndoshta, kontrastet më të thella të Ballkanit, aspo edhe të Europës mbarë. Në nivel lokal, pellgjet e brendshme dhe luginat e larta regjistrojnë në verë ditë tepër të nxehta dhe net të freskëta, për të mos thënë të ftohta.

Tashmë është fakt i njohur që ekzistenca e gradientëve të tillë të temperaturave dhe afria e madhe e detit prodhojnë erëra mbizotëruese. Erërat e verës - të nxehta, të thata dhe të ashpra - të ardhura nga jugu mesdhetar, quhen *juga* në Korçë ose në Gjirokastrë; erërat e fundit të pranverës, gjithashtu të ngrohta dhe të thata, të ardhura edhe ato nga jugu, njihen në Myzeqe me emrin *shirok*; erërat e vjeshtës së vonë - të ftohta, të thata dhe therëse - të ardhura nga juglindja, janë të njohura kryesisht me emrin *murrilan* në Shkodër, ndërsa erërat e dimrit, gjithashtu të ftohta dhe të thata, vijnë nga veriu, sikurse e tregon edhe emërtimi i tyre - *veri*. Sidoqoftë,

vlerat mesatare të shpejtësisë së erërave mbeten në mesataren e ulët - nga 2 deri në 5-6 metra/sekondë në dimër, për zonën bregdetare.¹³

Reshjet janë mjaft të bollshme në të gjithë vendin dhe veçanërisht të çrregullta, sipas relievit dhe zonave. Shpërndarja e tyre mbetet tipike mesdhetare, me një maksimum në dimër dhe një minimum në verë. Reshjet vijnë si rezultat i një qendërzimi përplasës të masave të ajrit me origjinë nga viset mesdhetare dhe të masave të ajrit kontinentale, që ndeshen në mënyrë të vazhdueshme në lartësi të terrenit. Kjo gjë shpjegon edhe bollëkun e reshjeve në zonat veriore dhe qendrore të vendit. Rryma të nxehta vertikale ajri me origjinë detare shkaktojnë shtrëngata me karakter të rrëmbyer, të shoqëruara shpesh me erëra të forta, me shira të vrullshme dhe shkarkime të fuqishme elektrike. Dobësimi i masës kontinentale të ajrit e lehtëson depërtimin e ajrit të lagësht mesdhetar dhe, si pasojë, reshjet shpërndahen në brendësi të vendit. Në rast të kundërt, reshjet përqendrohen në bregdet dhe në pjesën e ulët të relievit. Ky skenar tipik dimëror shoqërohet me uljen e temperaturave lokale, të cilat, herë-herë prekin vlera negative. Megjithëse fort e rrallë në ultësirën perëndimore, disa ditë në vit gjatë muajit janar, ngrica mund të prekë ullishtat dhe portokallishtat, gjë që i detyron kultivuesit t'i orientojnë plantacionet në shpatet e drejtuara nga jugu dhe perëndimi, paçka se temperaturat dimërore janë mjaft të larta. Ndërkohë, në zonat qendrore dhe veriore ngrica dhe akulli janë të pranishëm mbi 140 ditë në vit, gjatë një periudhe që shkon prej nëntorit deri në mars, madje edhe në prill.

Për sa i përket sasisë së reshjeve, ato arrijnë mesatare mjaft të larta dhe, për këtë shkak, mund të thuhet me plot gojën se Shqipëria gjendet mes vendeve të bekuara nga natyra. Vlerat mesatare vjetore luhaten nga 800 ose 900 milimetra/m² për zonat më të thata si Korça dhe Kolonja në juglindje të vendit; deri në 2.000-2.100 milimetra/ m² për zonën e Shkodrës dhe të Pukës në veri, ndërkohë që mesatarja vjetore në rang vendi është rreth 1.480 milimetra. Rajonet më të lagështa janë Alpet e Veriut, mesatarja vjetore e reshjeve në to shkon deri në 2.800, madje edhe tejkalon 3.000 mm/m².¹⁴

Me gjithë shiun dhe dëborën e dimrit, Shqipëria, sikundër dhe vende të tjera të pellgut mesdhetar, karakterizohet nga një numër i madh ditësh me diell. Mesatarisht dielli ndriçon përgjatë 2.400 orësh/vit në Shkodër dhe deri në 2.800 orë/vit në Sarandë, gjithashtu në verë gjatë bregdetit nuk ka asnjë ditë pa diell, falë aktivitetit të fuqishëm anticiklonik. E llogaritur në energji diellore të kapur në një metër katror në vit, vlerat e matura luhaten mes 1.400 dhe 1.700 kWh.

Reflekset e ujit

Në mënyrë të pashmangshme, gjithë ky ujë që bie nga qielli, shkon për të ushqyer ujërat sipërfaqësore: përrrenjtë, lumenjtë dhe liqenet, si dhe për të

mbushur shtresat nëntokësore ujëmbajtëse, pra, furnizon rrjetin hidrografik të vendit. Por, si rrjedhojë e klimës dhe si pasqyrim i strukturës gjeologjike të terrenit, hidrografia karakterizohet nga një çrregullsi e prurjeve dhe paqëndrueshmëri e rrjedhjeve. Sidoqoftë, rrjeti hidrografik sipërfaqësor mbetet jashtëzakonisht i pasur, sepse, jo vetëm tërësia e reshjeve që bie në Shqipëri mbledhet dhe transportohet nga lumenjtë lokalë, por ai grumbullon njëkohësisht një pjesë të madhe të ujërave të rajoneve kufitare. Kështu, në veri, vetëm dy a tri rrjedha uji krejt të papërfillshme dalin nga territori kombëtar dhe rrugëtojnë drejt Malit të Zi, Kosovës apo Maqedonisë, për t'u rikthyer përsëri në sistemin ujqor shqiptar. Edhe në skajin jugor, vetëm një e tillë rrjedh drejt Greqisë dhe përfundon në det. Në të kundërt, meqenëse vija e ndarjes së ujërave ndodhet diku larg në lindje, veri ose jug - në thellësi të territoreve malazeze, kosovare, maqedonase ose greke, Shqipëria grumbullon një masë të mjaft të rëndësishme uji nëpërmjet rrjetit hidrografik të fqinjëve. Mjafton të thuhet se sipërfaqja e përgjithshme ujëmbledhëse e pellgut hidrografik është 43.300 km² ose 1,5 herë më e madhe sesa territori kombëtar.

Për shkak të afërsisë së masiveve malore me bregdetin, lumenjtë janë pak a shumë të shkurtër. Më i gjati mes tyre mbetet Drini, që rrjedh përgjatë 258 kilometrash. Dendësia mesatare e rrjetit hidrografik është tepër e lartë: 1,4 km/km². Vlerat më të larta janë karakteristike të atyre zonave që përmbledhin nivelet më të mëdha të papërshkueshmërisë të terrenit (shkëmbinj magmatikë, flyshe dhe grese të buta argjilore), shpate të rrëpirëta të relievit dhe intensitete të larta reshjesh. Kështu, pellgu i Matit arrin në krye me 3,4 km/km², i ndjekur nga ai i Semanit (2,5 km/km²) dhe ai i Erzenit (2,1 km/km²). Në anën tjetër të shkallës ndodhet Drini, sigurisht për shkak të kalimit të tij në zonat shkëmbore gëlqerore të Dukagjinit ose të Alpeve që, për hir të infiltrimit dhe migracionit të ujit drejt shtresave të nëndheshme, mbeten të varfër në rrjedha mbetokësore.

Fakti që reshjet prekin kryesisht pjesën më të lartë të relievit, po ashtu dhe çrregullsia e tyre stinore përcaktojnë një karakteristikë të përbashkët të të gjitha rrjedhave të ujit të vendit, si dhe i kufizojnë së tepërmi vlerat e tyre ekonomike.¹⁵ Lumenjtë shkaktojnë gërryerjen intensive të terrreneve malore në një shkallë pothuaj njëqind herë më të lartë sesa mesatarja europiane dhe transportojnë masa të mëdha sedimentesh, që depozitohen në luginat dhe në ultësirën bregdetare, duke ndikuar fort në shtrirjen dhe zgjerimin e saj.


Gjatë verës, kur thatësira fillon dhe ndihet dhe bëhet e domosdoshme ujitja e tokës, pjesës më të madhe të lumenjve i mungon rrjedhja dhe ata shndërrohen në vija të thjeshta uji. Sidoqoftë, mjafton një stuhi vere që ata të bëhen të pakontrollueshëm dhe ndonjëherë madje të rrezikshëm. Asnjë prej lumenjve nuk është i lundrueshëm, përveç Bunës. Ky lumë krejt i veçantë me një gjatësi prej vetëm 40 kilometrash, lidh liqenin e Shkodrës me detin Adriatik

dhe lejon lundrimin e anijeve të lehta. Në krahasim me qëndrueshmërinë aq karakteristike të shtratit së tyre të sipërm përgjatë kalimit mes masiveve malore, lumenjtë shqiptarë e ndërrojnë vazhdimisht shtratin me daljen në ultësirë, duke shpërdoruar shumë më tepër tokë pjellore sesa krijojnë.

Të gjithë lumenjtë e vendit, me përjashtim të dukshëm të Drinit të Zi, rrjedhin drejt perëndimit. Kalimi për në det bëhet mes për mes masiveve malore, ku ata kanë gërryer lugina të thella, në vend që t'i anashkalonin. Për ta shpjeguar këtë fenomen gjeologjik, në pamje të parë të pamundur, duhet hamendësuar se fillimisht, pllajrat e brendshme duhet të kenë qenë mjaft të larta dhe ndoshta mjaft të rrafshëta, të krijuara në të njëjtën kohë me lindjen e rrjedhjeve të ujit¹⁶. Shtypja, përthyerja dhe së fundi, ulja e pllajave, me sa duket, është proces më i vonë. Ky proces gjeologjik në pjesën më të madhe të rasteve mendohet se ka qenë tepër i shpejtë, gjë që shkaktoi pengimin e rrjedhjeve të ujit dhe krijimin e liqeneve të brendshme. Këto liqene kanë mundur të ekzistojnë derisa shtretërit primitivë të rrjedhave të ujit u bënë aq të rëndësishëm sa të shkaktonin rrjedhjen e ujit drejt detit. Ndërkohë, masa e sedimenteve e transportuar drejt këtyre liqeneve arkaike ka mundur t'i mbushë ata plotësisht, duke krijuar pellgje të brendshme (p.sh.: i Kukësit, i Peshkopisë, i Pogradecit, i Korçës ose i Kolonjës), që, jo rastësisht, gjenden në të ashtuquajturën *hulli shqiptaro-tesaliane*, e cila përshkon pjesën lindore të vendit nga veriu në jug.

Përfundimisht, përkulja e relievit dhe e pllajave nuk ka qenë aq e theksuar, sa të mund t'i detyronte ujërat ta ndryshonin në mënyrë rrënjësore drejtimin e rrjedhjes përgjatë rrugëve apo kalimeve të tjera. Në ato vende ku ulja e terrenit është tepër e fuqishme, këto liqene kanë mundur të mbijetojnë deri në ditët tona, siç është rasti i liqenit të Ohrit ose liqeneve të Prespës.

Tre liqenet lindore të Shqipërisë - liqeni i Ohrit, liqeni i Prespës së Madhe dhe ai i Prespës së Vogël - bëjnë pjesë në kategorinë e liqeneve tektonike dhe ndodhen në një zonë kufitare mjaft të lartë dhe piktoreske, mes 700 - 850 metrave mbi nivelin e detit. Terreni rrethues është pak a shumë i sheshtë, por pjellor dhe kjo gjë krijon kushte jetese mjaft të përshtatshme, si dhe mjaft më të mira se në zona të tjera të vendit, që janë çuditërisht shumë më të populluara se të parat. Tërë liqenet ndahen mes fqinjëve. Kështu, liqeni i Ohrit (358 km², me thellësi mesatare 155 metra dhe thellësi maksimale 289 metra, si dhe me një sipërfaqe ujëmbledhëse të drejtpërdrejtë prej 1.310 km²) ndahet mes Shqipërisë, e cila zotëron diçka më tepër se një të katërtën e sipërfaqes ujore (97 km²) dhe Maqedonisë, së cilës i përket pjesa që mbetet.



Shqipëria - gjeografia fizike

Liqeni i Prespës së Madhe (259 km², me thellësi mesatare 14 metra dhe thellësi maksimale 48 metra, si dhe me një sipërfaqe ujëmbledhëse prej 1.300 km²) ndahet mes Shqipërisë, që zotëron më pak se një të pestën e sipërfaqes ujore (46 km²), Maqedonisë (176 km²) dhe Greqisë (36 km²). Liqeni i Prespës së Vogël (48 km², me thellësi mesatare 4.1 metra dhe thellësi maksimale 8.4 metra) i përket Shqipërisë vetëm në një pjesë të vogël (8 km²), ndërsa pjesa tjetër i takon Greqisë.

Bashkësia e këtyre tre liqeneve përfaqëson sistemin më interesant dhe më të rëndësishëm ekologjik të vendit. Natyra e tyre tektonike, sistemi i nëndheshëm i komunikimit të ujërave nëpërmjet masivit gëlqeror-karstik të vargut Galicica - Mali i Thatë, cilësia e jashtëzakonshme e ujit që zëvendësohet dhe rrjedh në mënyrë të vazhdueshme, fauna dhe flora e tyre e shënuar e cila grumbullon: pelikanin e bardhë dhe krillën e hirtë, troftën e madhe dhe të vogël të liqenit (koreanin e belushkën), persianin e madh dhe krapin e liqenit, sfingjerin e rrumbullakët dhe karavidhen e gjelbër, të gjitha këto përcaktojnë natyrën fort të veçantë të këtij ansambli hidrik në Ballkan dhe në Europë¹⁷. Zona rreth dy liqeneve të Prespës, me sipërfaqe 27.750 hektarë, është përfshirë në gjirin e parkut natyror ndërkufitar me shtrirje në tre vendet fqinje, ndërsa zona perëndimore dhe jugore rreth liqenit të Ohrit, me një sipërfaqe prej 27.300 hektarësh, është shpallur *“peizazh i mbrojtur”*.

Pa asnjë gabim të mundshëm, liqeni më i madh i vendit është Liqeni i Shkodrës, i cili ka gjithashtu origjinë tektonike, si dhe karstike. Ai ushqehet në mënyrë të vazhdueshme prej një vargu përrenjsh si Vraça, por edhe lumenjsh si Moraça apo edhe burimesh të nëndheshme, pjesa më e madhe e të cilave gjenden në territorin e Malit të Zi dhe furnizojnë deri në 93% të prurjes në ujë. Regjimi ujqor i këtij liqeni me një sipërfaqe ujëmbledhëse prej 5.180 km² shtrihet në një zonë alpine me reshje shumë të bollshme, që shkaktojnë luhajtje të forta stinore të thellësisë (10 metra maksimum dhe 5-6 metra thellësi mesatare), duke bërë që sipërfaqja e kësaj shtrirjeje të madhe ujore të dyfishohet dhe t'i kalojë 353 km² që ka në piskun e verës, duke u ngjitur në 540 km² në pranverë. Sidoqoftë, vetëm 40% e sipërfaqes së liqenit (142 km²) i takon Shqipërisë. Pjesa e tij lindore - nga Hani i Hotit deri në hyrje të qytetit të Shkodrës - dhe pjesa jugore (nga dalja e Bunës deri në skaj të Shirokës), me një sipërfaqe prej 265 km² është shpallur *“rezervat i mirëmbajtur natyror”*. Mes përfaqësuesve më të shquar të faunës të këtij liqeni janë: saraga dhe krapin, kubla dhe ngjala, sikundër dhe kredharaku xhuxh mes shpendëve të ujit¹⁸.

Një tjetër kategori është ai i liqeneve karstike, të formuara mbi një shtrat shkëmbinjsh me përmbajtje gëlqerore dhe gipsore. Përfaqësuesit më të denjë të tyre janë liqenet e Belshit në krahinën e Dumresë: një grup prej 85 liqenesh, më të rëndësishmit e të cilëve janë: Çestinja (95 hektarë),

Seferani (87.5 hektarë) apo Dega (37.5 hektarë), ndërsa më i vogli (Çartallosi) ka një sipërfaqe prej gjysmë hektari. Thellësia e tyre maksimale luhet nga 60 metra (liqeni i Merhosë) në 20 metra (Seferani) dhe mbetet funksion i drejtpërdrejtë i regjimit ujqor, i cili varet kryekëput nga kushtet atmosferike (reshjet dhe temperaturat e ajrit), pasi këto liqene janë të izoluara dhe pa asnjë komunikim me rrjetin ujqor fqinj¹⁹.

Duke iu rikthyer lumenjve, për një varg arsyesh, Drini meriton vendin e parë në ansamblin e rrjedhjeve sipërfaqësore të vendit. Dega e tij kryesore, Drini i Zi (5.885 km² pellg ujëmbledhës) buron nga liqeni i Ohrit dhe, pas një vrapit prej dyzet kilometrash nëpër territorin maqedonas, pret kufirin shqiptar për të përshkuar mbi njëqind kilometra të tjerë, para se të sjellë prurjen mesatare vjetore prej 118 m³/s në liqenin e Fierzës. Ky liqen i krijuar nga dora e njeriut për nevoja energjetike mbledh njëkohësisht edhe ujërat e degës tjetër kryesore, Drinit të Bardhë, i cili buron në lartësitë e Zhelebitit, diku në Sanxhak, i cili, pasi përshkon rreth 140 kilometra në territorin malazez dhe atë kosovar, duke grumbulluar një varg degësh të vogla në ato 5.000 km² të pellgut të tij, hyn në territorin shqiptar dhe sjell një prurje mesatare vjetore prej 68 m³/s.

Në vijim, pasi braktis liqenin e Fierzës, që përmbyt një pjesë të madhe të shtratit të vjetër të lumit, lumi Drin rrjedh edhe nja pesëdhjetë kilometra të tjerë dhe derdhet në një liqen të dytë, në liqenin e Komanit,ⁱⁱ një tjetër rezervuar gjigant i krijuar gjithashtu për nevoja energjetike. Më tej, sapo del nga turbinat e hidrocentralit të Komanit, Drini bie në një rezervuar të tretë, atë të Vaut të Dejës dhe, duke e braktisur edhe atë, i afrohet qytetit të Shkodrës, ku edhe metamorfozohet: pjesa më e madhe e ujërave të tij shkon drejt bashkimit me një lumë tjetër, Bunën, i cili del nga Liqeni i Shkodrës dhe derdhet në detin Adriatik. Pjesa e mbetur e Drinit ndjek shtratin e vjetër, që diku, i bashkuar me lumin e Gjadrit, përdredhon rreth Lezhës dhe derdhet përfundimisht në det, pranë portit të Shëngjinit. Gjithsej bëhet fjalë për një pellg ujëmbajtës prej 19.600 km² dhe një prurje mesatare vjetore në nivelin e derdhjes së Bunës prej 680 m³/s, nga të cilët, 320 m³/s janë të vetë Bunës. Kjo prurje vjen si rezultat i një regjimi nivoplivial me dy maksimume: i pari në dhjetor, që përkon me maksimumin e reshjeve pluviale (të shirave), i dyti në pranverë, në mars, përkon me shkrirjen e dëborës.

I vetmi konkurrues pak a shumë i denjë në pjesën veriore të vendit është lumi i Matit, i cili buron në masivin e Martaneshit dhe kalon mes një vargu grykash të ngushta përpara se të grumbullojë ujërat e një pellgu ujëmbledhës

ⁱⁱ Liqeni artificial i Fierzës është krijuar nëpërmjet ndërtimit të një dige dheu prej 170 metrash të lartë. Ai ka një sipërfaqe prej 72.5 km², thellësi maksimale prej 178 metrash dhe përmban 2.7 km³ ujë. Liqeni i Komanit, diga e të cilit ngrihet deri në 130 metra, ka një sipërfaqe ujore prej 12 km².

prej 2.440 km² dhe t'i derdhë ujërat e veta në liqenin artificial të Ulzës, i ngritur për të prodhuar energji elektrike. Sapo del prej këtij liqeni, Mati bashkohet me degën e tij kryesore Fanin (Fani i Madh dhe Fani i Vogël me një pellg ujëmbledhës prej 1.100 km²), i cili zbret nga malësitë e Mirditës dhe duke përshkuar ultësirën perëndimore, shkon drejt derdhjes në detin Adriatik. Përfundimisht, lumi i Matit me një gjatësi të përgjithshme prej 144 kilometrash, zotëron një prurje mesatare vjetore prej 103 m³/s, e cila reduktohet në një të dhjetën e saj në muajin gushtⁱⁱⁱ.

Një lumë tjetër, Shkumbini, e pret vendin pothuaj në dysh. Buron në malet e Mokrës dhe gjatë rrjedhjes së sipërme mbledh një varg përrënsh malorë si: Bushtrica, Hotolishti në hyrje të Librazhdit, Gostima dhe Zaranika pranë Elbasanit; më tej, pasi shman nga jugu Rrogozhinën, e përfundon vrapin prej 180 kilometrash në detin Adriatik, ku derdh mesatarisht 60 m³/s ujë. Ky lumë ka një pellg ujëmbajtës prej 2.500 km².

Më në jug, një tjetër lumë i rëndësishëm, Semani, gjarpëron nëpër fushën e Myzeqesë. Në të vërtetë ai lind pranë qytetit të Kuçovës, nga bashkimi i dy lumenjve të tjerë: Osumit dhe Devollit. Osumi i ka burimet në lartësitë e malit të Lofkës, diku përballë Ersekës. Ende përrua, ai përshkon krahinën e Skraparit, si edhe 25 kilometra kanione të thella, përpara se të shndërrohet në lumë dhe të kalojë mes për mes Beratit gjatë një rrugëtimi prej 161 km. Pasi ka grumbulluar mesatarisht 32 m³/s ujëra në pellgun e tij prej 2.073 km², ai bashkohet me lumin e Devollit, i cili buron diku në shpatin juglindor të malit të Moravës, në lartësitë e fshatit Arrëz. Pas një rrugëtimi prej 196 kilometrash mes fushës së Bilishtit, të Korçës, grykave të Gramshit dhe të Sulovës, Devolli sjell mesatarisht 50 m³/s ujëra në shtratin mëmë të Semanit, i cili gjatë verës shndërrohet në një lumë pothuaj fantazmë, pasi i mbetet vetëm një e pesëmbëdhjeta e prurjes së tij të muajit mars.

Përfaqësuesi më jugor i familjes së lumenjve është Vjosa, lumi i dytë i vendit për nga karakteristikat e rrjedhjes; ka një gjatësi prej 272 km dhe një pellg prej 6.360 km². Vjosa vjen nga mjaft larg, nga masivi i Zagorionit në Greqi. Në tokat epirote lumi mbledh ujërat e një pellgu të gjerë prej 2.400 km² dhe pret kufirin shqiptar diku pranë Leskovikut, rrjedh nën Përmet dhe çan përmes grykës së Këlcyrës përpara se të mbledhë disa degë të rëndësishme si Drino i cili vjen nga përtej kufirit dhe rrjedh poshtë Gjirokastrës, ose Shushica që zbret nga malet e Kurveleshit. Rrjedha e qetë e Vjosës vazhdon

ⁱⁱⁱ Dy lumenj të tjerë, të një rëndësie më të vogël, ndajnë hapësirën qendrore të vendit deri në afërsi të qytetit të Tiranës: Ishmi dhe Erzeni. Ata kanë një pellg të përbashkët ujëmbledhës prej 1.450 km²; burojnë në masivin malor që ngrihet në shpinë të qytetit të Krutës dhe Tiranës dhe përdredhohen në ultësirën perëndimore përgjatë disa dhjetëra kilometrash përpara se të përfundojnë, sikundër shumica dërrmuese e gjithë të tjerëve, në detin Adriatik, ku të dy bashkë derdhen një prurje mesatare prej 39 m³/s.

drejt detit Adriatik, disa kilometra në veri të Vlorës, ku derdh mesatarisht 195 m³/s ujëra.

Të gjithë këta lumenj, pa përjashtim, janë transportues të mëdhenj sedimentesh që përfundojnë edhe ato në det, duke ndihmuar në zgjerimin e mëtejshëm të ultësirës perëndimore, të cilën e kanë mbushur gjatë shekujsh.

* * *

Sasia dhe cilësia natyrore e ujërave nëntokësore, që përbëjnë burimin kryesor - për të mos thënë të vetëm - të ujit të pijshëm të vendit, është funksion i strukturës dhe i natyrës hidraulike të terrenit. Mes tyre dallojmë ujëmbajtës të përshkueshëm të kapaciteteve të mëdha - shtresa rëre kokërrmadhe dhe zhavorri, ujëmbajtës me thyerje të natyrës karstike-karbonatike të kapaciteteve të mëdha ose të mesme, shkëmbinj me thyerje të natyrës ultrabazike ose vullkanike me kapacitete të kufizuara ose të vogla ujore.

Terrenet e përshkueshme ujëmbajtëse të llojit me shtresa rëre kokërrmadhe dhe zhavorri gjenden kryesisht në ultësirën perëndimore dhe, jo rastësisht, janë pjesë përbërëse të pellgjeve kryesore lumore (dy të tillë në pellgun e poshtëm të Drinit: i pari pranë Shkodrës, i dyti në fushën e Zadrimës; një në pellgun e Matit, mes Lezhës dhe Mamurrasit; dy të tjerë, me përmasa të kufizuara, në pellgun Erzen - Ishëm; dy në pellgun fushor të Shkumbinit pranë Rogozhinës dhe Lushnjës; dy në pellgun Devoll-Seman: i pari, pranë Kuçovës, i dyti në fushën e Korçës; tre mjaft të rëndësishëm në pellgun e Vjosës: një i poshtëm mes Vlorës dhe Fierit, një tjetër i Drinos pranë Gjirokastrës dhe i treti në fushën e Sarandës). Këta ujëmbajtës karakterizohen përgjithësisht nga prurje të mëdha (disa dhjetëra litra/sek apo disa m³/sek) me luhatje stinore, ndërsa cilësia e ujit, si rregull, përkeqësohet në afërsi të bregdetit (për shkak të ndërftjes së ujit të kripur) ose në afërsi të qyteteve dhe zonave ku ka bujqësi intensive (për arsye të ndërftjes së derdhjeve industriale ose ndotjes bujqësore). Shfrytëzimi i tyre realizohet me puse arteziane, që shkojnë deri në disa dhjetëra metra thellësi.

Ujëmbajtësit me thyerje të natyrës karstike-karbonatike janë të gjithëgjendur, kryesisht gëlqerorë dhe dolomite. Ata shtrihen në mbi 6.500 km², që është rreth 1/4 e territorit të vendit²⁰ dhe materializohen në sipërfaqe në formën e një vargu masivesh malore. Por ka gjithashtu edhe sektorë të tërë të nënzonës joniane dhe të nënzonës së Krujës ku strukturat gëlqerore-dolomite janë mbuluar nga shtresa molase dhe flyshi. Për shkak të fenomeneve të njohura të karstit - gërryerje hidrokimike dhe hidraulike e shkëmbinjve pjesërisht të tretshëm - këto masive shpesh paraqiten në formë rrafshesh të larta, mes tyre, më tipiket janë: Alpet shqiptare, Mali me Gropa, Mali i Thatë

ose Mali i Gjerë. Përshkueshmëria e lartë hidraulike e këtyre mjediseve bën që ujërat të transportohen me anë çarjesh, kanalesh apo edhe me përrenj të vërtetë nëntokësorë në thellësi të tyre, ku grumbullohen për të dalë në formë burimesh aty ku strukturat e ndërrojnë natyrën ose në ndërprerjen me luginat e thella lumore. Të tilla burime gjenden në Selitë (me prurje maksimale 0.6 m³/sek) dhe Shëmri (me 0.7 m³/sek) - në rrëzë të Malit me Gropa; Uji i Zi i Këlcyrës (me 6.0-7.0 m³/sek), që del në rrëzë të Dhëmbel-Nemërçkës në grykën e Këlcyrës dhe derdhet në Vjosë; Uji i Ftohtë i Vlorës (me 2.5 m³/sek) në rrëzë të malit të Tragjasit, i cili derdhet në det; burimi i Viroit në Gjirokastër (me prurje 0-50 m³/sek) apo burimi i Pëllumbasit në grykën e Skoranës (me 0.6 m³/sek), që derdhet në Erzen.

Në këtë skemë ujore, ujëmbajtësit e përbërë paraqiten si një nyjë e rëndësishme dhe kanë një sipërfaqe të përgjithshme prej 2.000 km² ose sa 1/3 e sipërfaqes së ujëmbajtësve karstikë. Ata kombinojnë karakteristikat hidraulike të dy llojeve të tjera, pra, të ujëmbajtësve me shtresa rëre kokërrmadhe e zhavorri dhe të ujëmbajtësve me thyerje të natyrës karstike-karbonatike. Përfaqësuesit më të denjë të ujëmbajtësve të përbërë janë ndërkufitarët e liqenit të Shkodrës, në këmbë të Alpeve (kufiri shqiptaro-malazez), liqeni i Ohrit dhe liqenet e Prespës në këmbë të masivit Mali i Thatë - Galiçica (kufiri shqiptaro-maqedonas), si dhe të masivit malor Mali i Gjerë - Mourgana në kufirin shqiptaro-grek. Burimet më të përmendura të këtyre ujëmbajtësve janë: Syri i Sheganit pranë Koplikut (me prurje 1-10 m³/sek), ujërat e Tushemishtit (me 2.5-3.5 m³/sek) dhe Syri i Kaltër pranë Muzinës (me 18.5 m³/sek). Ujërat e tyre vijnë pjesërisht nga terrenet e përshkueshme rrethuese dhe pjesërisht nga masivet karstike ngjitur me to. Kurba e prurjeve njeh dy maksimume (në prill-maj me shkrirjen e dëborës dhe në dhjetor me kulmin e reshjeve), si dhe dy minimume (në tetor si pasojë e thatësirës së verës dhe në shkurt si pasojë e ngricave)²¹.

Një vëmendje të veçantë tërheq veprimi i ujërave mbi vijën bregdetare. Gjeomorfologjia e terrenit nxjerr në pah faktin se bregdeti shqiptar është përfshirë në dy regjime të ndryshme dinamike: zona jugperëndimore joniane nga Kepi i Karaburunit deri në Kepin e Stillos, thuajse pa rrjedhje lumore, i nënshtrohet një dinamike negative, ndryshe, ajo gërryhet nga deti dhe tërhiqet; zona veriperëndimore nga rrjedhja e Bunës deri në skajin më jugor të gjirit të Vlorës, ku derdhen gati të gjitha rrjedhjet lumore të vendit, i nënshtrohet kryesisht një dinamike pozitive, pra, mbushet me sedimente dhe hyn në det²².

Në të vërtetë, kjo skemë e thjeshtuar fsheh një varg veprimesh ndërsjellëse, të ndikuara nga regjimet hidrologjike të rrymave detare, nga regjimet termike të ajrit dhe të ujit, nga veprimtaria tektonike e brigjeve... efektet lokale të të cilave janë të dukshme dhe maten nëpërmjet shmangieve nga tendencat e

përgjithshme. Kështu, në nivelin e bregdetit adriatik, krahas zonave tipike, ku deti tërhiqet si pasojë e depozitimit të sedimenteve lumore (derdhja e Bunës, derdhja e Matit dhe Erzenit, derdhja e Shkumbinit dhe Semanit ose derdhja e Vjosës) dhe, si pasojë, janë krijuar një varg plazhesh ranore, ekzistojnë sektorë (Rodoni, Palla, Kryevidhi dhe Zvërneci) ku gërryerja e strukturave të molasës kodrinore është një fenomen ende i prekshëm, sikundër dhe sektorë të tjerë (plazhi i Semanit, sektori i Porto Romanos, plazhi i Patokut), ku deti ndërfitet në tokë me një ritëm prej 8-10 metrash në vit.


Gjarpërimet e zjarrit

Nga veriu në jug bregdeti perëndimor i gadishullit të Ballkanit, ku gjendet edhe Shqipëria, ofron një peizazh pothuaj të pandryshuar: përgjatë tërë brigjeve dhe ishujve dalmatë (malet Dinarike dhe Alpet malazeze) ngrihet një mur i bardhë gëlqeror, i cili rishfaqet menjëherë pasi kapërcen kepin e Karaburunit për të përfunduar në jug të Greqisë, me Peloponezin e ashpër. Mes këtyre dy pengesave natyrore, vështirësisht të depërtueshme, bregdeti ranor shqiptar - prej Shkodrës deri në Vlorë - përfaqëson një kalim pothuaj të papritur, të vetmen portë të vërtetë që lejon depërtimin dhe përshkimin e Ballkanit, thuajse në vijë të drejtë nga perëndimi në lindje.²³

Qysh prej kohësh të lashta kjo portë është kaluar rregullisht nga njëra ose nga ana tjetër prej të gjithë pushtuesive: legjionet romake gjatë shekujt III-II p.e.s. për të mbërritur në Maqedoni, në Dardani ose në Trakë; gotët dhe barbarë të tjerë që, pasi kishin rrënuar gadishullin, lakmonin brigjet përballë; ushtritë e Bizantit, duke filluar nga shek. VII për të zbarkuar në Itali; saraçenët dhe arabë të tjerë për të grabitur viset e brendshme; bullgarët e Simeonit në shek. X, që ëndërronin të preknin brigjet adriatike; normanët e Siqelisë dhe kryqtarë të tjerë në shekujt XI-XII, të cilët shpresonin të pushtonin Lindjen mbarë; tregtarët venedikas që shkëmbenin me brendësinë e vendit nga bazat e tyre bregdetare; hordhitë osmane për të mposhtur rezistencën arbëre dhe për të kërcënuar brigjet italiane; arbit vetë për të braktisur vendin e tyre të robëruar.

Në një epokë mjaft më të afërt, të tjerë kalimtarë dhe pushtues kaluan përmes kësaj porte: ushtritë e Antantës së trefishtë për të luftuar kundër ushtrive kundërshtarë të Aleancës po aq të trefishtë; ushtria e shpartalluar serbe për t'u strehuar në Korfuz; divizionet fashiste të Musolinit për të pushtuar Shqipërinë dhe për të sulmuar Greqinë...

Ripi kënetor dhe i shkretë që dikur përzgjatej në breg të detit, ofronte të paktën tri pika të sigurta zbarkimi, mjaft të mbrojtura nga erërat e veriut dhe të jugut: Shëngjini, porti i Lezhës në gjirin e Drinit, nën hijen e malit



Rruga “Egnatia”

[Sipas një ideje të Philip CURTI - *The Via Egnatia*]

të Rrencit; Durrësi, i mbrojtur nga Bishti i Lagjit, në skaj të gjirit të hapur me të njëjtin emër; Vlora, e mbrojtur nga gadishulli shkëmbor i Karaburunit dhe ishulli i Sazanit.^{iv} Nga këto qytete niseshin edhe rrugët më të mëdha transversale të gadishullit, të cilat gjarpëronin përmes atyre kalimeve të rralla që hapen në mes të murit malor të prapatokës shqiptare.

Më e vjetra dhe më e njohura nga të gjitha është rruga “Egnatia”, ekzistenca e së cilës dokumentohet fare qartë qysh në vitet e para të erës së re nga Straboni, në librin VII të Gjeografikës.²⁴ Asokohe, “Egnatia” lidhte Apoloninë me pjesën lindore të Maqedonisë dhe shkonte deri në Cipsela, mbi lumin Hebros (Ipsala e sotme, pranë lumit Marica-Evros), me një gjatësi prej 535

^{iv} Një gji i katërt, ai i Sarandës (i Dyzet Shenjtorëve) ofron një mbrojtje të sigurt përballë ishullit të Korfuzit. Pikërisht ky ishull përballë, i vlerësuar prej kohëve të lashta si kyçi i Adriatikut, e ka lënë në hije bregun shqiptar të atyre anëve, aq më tepër që ky port i vogël përballët me një vështirësi tjetër serioze: i vetmi komunikim me brendësinë e vendit realizohet nëpërmjet Qafës së Muzinës dhe çon në rrugëkalimin Gjirokastër-Janinë, i cili nuk paraqet ndonjë interes ekonomik të dorës së parë.



Sistemi i rrugëve antike në territorin shqiptar

[Sipas një ideje të: Vladislav POPOVIC - *Byzantins, Slaves et autochtones dans les provinces de Prévalitane et Nouvelle Épire*]

miljesh romake.^v Mendohet se kjo rrugë ushtarake dhe tregtare kalonte nëpër gjurmët e një rrugëtimi të lashtë baritor ndërballkanik, pjesa ilirike e të cilit njihej prej helenëve me emrin Rruga e Kandavisë. E përdorur nga romakët për të depërtuar në Maqedoni qysh në shek. II p.e.s., ajo u quajt “Egnatia”, sipas gjasave, për hir të njëfarë Egnatiusi, prokonsull romak i Maqedonisë²⁵.

“Bulevardi” antik i shtruar me kalldrëm, gjurmët e të cilit dallohen edhe në ditët e sotme, zinte fill në Apoloni dhe gjarpëronte në ultësirën bregdetare rreth Klodianës (Peqinit të sotëm), ku takohej me pjesën e saj fushore, e cila zinte fill në portin e Dyrrakiumit (Durrësit). Më tej, rruga piquej me rrjedhën e lumit Genusus (Shkumbin) dhe përshkonte qytetin Skampa (Elbasan)^{vi} dhe përzgjatej kështu në luginën e mesme të Genusut e më tej ngjitej në tarracat e sotme të Librazhdit, deri në vendin e quajtur Tres Tabernas (Qukës), për ta vazhduar ngjitjen drejt burimeve të lumit, në thellësi të krahinës antike të Kandavisë.²⁶ Përgjatë luginës, shtyllat e vjetra romake dhe harqet e mëvonshme osmane ia lënë vendin njëra-tjetrës, ashtu sikundër i ka vrojtuar edhe udhëtari i fillimit të shek. XX.²⁷ Duke u kacavarur në shpatet e para të Mokrës, rruga “Egnatia” e braktiste shtratin e Genusut dhe ndiqte shtratin e përroit të Longaricës (Lingajcës) deri pranë Përrenjasit. Në vijim, pasi përshkonte fushën e Domosdovës, mbërrinte në Urakë dhe kapërcente pengesën e parë serioze - Qafën e Thanës, me një lartësi prej 926 metrash. Aty, nga ana tjetër e qafës, thellë poshtë, hapet një pamje e papritur: liqeni oval i Ohrit, të cilin rruga e rrethqarkonte nga veriu, nëpër Strugë dhe Lyknidë (Ohër).

Nga Lyknida, rruga binte në shtratin e lumit Koselska dhe ngjitej drejt malit të Istokut, në veri të masivit të Galicicës, të cilin e kapërcente përmes një qafe në lartësinë 1.180 metra, përpara se të binte në pellgun e Prespës dhe të kalonte përmes Brucidës (pranë Resnjës së sotme). Përfundimisht, një vargmal i tretë i ofronte “Egnatias” një kalim në lartësinë 1.158 metra, pas të cilit ajo përshkonte qytezën Nikea (Kazhani i sotëm), binte në shtratin e lumit Dragor dhe hynte në rrethinat e qytetit të vjetër Herakleia Lynkestidas (Manastiri i dikurshëm dhe Bitola e sotme).

Nga Herakleia Lynkestidas zgjatimi i saj i natyrshëm synonte qytetin-port Thesalonikas (Selaniku) në detin Egje. Në vazhdim, duke lënë mënjanë qytetin e Follorinës, rruga kalonte një qafë mali dhe binte në Kleidi (Klidi i sotëm), dredhonte në veri të liqenit Vegoritis dhe përshkonte radhazi dy

^v *Milje* romake - njësi gjatësie e epokës, afërsisht 1.480 metra.

^{vi} Një shteg tjetër anësor i ndjekur nga rruga “Egnatia” me pikënisje Klodianën, ndiqte rrjedhën e përroit të Pezës dhe piquej me lumin Rzan (Erzen) diku pranë Pezë-Helmësit për të ndjekur luginën deri në Arbanë, nga ku ajo ose gjarpëronte nëpërmjet luginës së përroit të Zhullimës për të zbritur në Papër ku piquej rishtas me luginën e lumit Genusus, ose ngjitej drejt Petrelës dhe malësisë së Kërrabës për të zbritur në Fikas dhe për dredhuar drejt qytetit Skampa.

qytet: Edesën dhe Pellën në fushë; më tej kapërcente lumin Aksios (Vardar) dhe hynte në Thesalonika.

Një segment ndërmjetës i kësaj rruge realizonte lidhjen mes Thesalonikasit dhe Cipselasit, në brigjet e lumit Hebros. Pasi përshkonte veriun e gadishullit të Kalkidias ajo prekte qytete me radhë: Argolisin (Asprovalta) dhe Amfipolisin, kalonte pranë Neapolisit (qytetit të sotëm të Kavallës), Ksanthit dhe Komotinit; i qasej bregdetit të Egjeut në Aleksandropolis dhe, përfundimisht, ngjitej drejt verilindjes deri në brigjet e lumit Hebros. Prej Cipselas zinte fill segmenti i fundit i rrugës, që çonte në Kostandinopojë.

Në epokën romake "Egnatia" ishte një nga rrugët më të rëndësishme ushtarako-tregtare tokësore të Gadishullit Ballkanik - *cursus publicus*, por ajo e humbi rëndësinë, edhe përdorimin gjatë dyndjeve barbare të shekujve V-VIII e.s. Këtë status të nderuar e rigjeti pas ringritjes të Perandorisë Bizantine gjatë shekujve X-XI. Pjesa lindore e rrugës deri në Thesalonika shërbeu si drejtim kryesor i depërtimit osman në Ballkan, ndërkaq pjesa perëndimore ose shqiptare e humbi rëndësinë pas pushtimit osman, ra në harresë dhe në rrënim. Vetëm pas krijimit të Shtetit të pavarur shqiptar, "Egnatia" u rivlerësua si një nga arteriet kryesore të vendit dhe u riparua pjesërisht nga italianët. Për arsye të ndryshme, kryesisht politike, ajo nuk u përdor më në tërësinë e saj gjatë një gjysmë shekulli, meqenëse perdja e hekurt i ndante tashmë fqinjët ballkanikë dhe rruga ndërpritej pranë kufirit shtetëror. Sidoqoftë, ajo mbeti korridori më i rëndësishëm perëndim-lindje në nivelin lokal, një mënyrë e sigurt për të lidhur zonën e liqeneve me bregdetin adriatik, pasi mbi trasenë e saj të vjetër kalon një rrugë kombëtare dhe një udhë e hekurt. Tanimë ajo siguron komunikacionin mes Shqipërisë dhe Maqedonisë nëpërmjet një pike kufitare në lartësitë e liqenit të Ohrit, ndërsa zgjatimi i saj natyror shërben për pellgun e Korçës dhe, nëpërmjet pikës kufitare të Kapshticës, lejon kalimin drejt Follorinës në Greqi. Disa projekte ndërballkanike synojnë ta rigjallërojnë këtë lidhje të vjetër, me qëllimin për të ngritur një autostradë ballkanike, e cila, sipas projekteve, duhet të ndjekë trasenë e dikurshme të rrugës "Egnatia".

Në territoret ilirike rrjeti i komunikacionit të lashtë romak plotësohej me aksin rrugor veri-jug, i cili përzgjatej në ultësirën bregdetare: me pikënisje Dyrrakionin, dega jugore e saj ndiqte një kalim të vjetër të njohur qysh nga periudha helene, që e çonte udhëtarin në Apoloni. Nëpërmjet kalimit bregdetar në rrëzë të Petras (Shkëmbit të Kavajës), rruga përshkonte fushën e sotme të Kavajës deri në Gosë dhe, duke lënë më të djathtë Rrogozhinën, orientohej drejt bregdetit adriatik (Bashtovë) dhe linte në krah Gradishtën për të zbritur drejt jugut, në rrëzë të fushës së sotme të Fierit, nëpër Libofshë dhe Mbrostar, deri në kodrat e buta të Apolonisë. Në rrethinat e Fierit të sotëm një degëzim i saj ndiqte rrjedhën e sipërme të lumit Gjanica dhe përfundonte në Bylis

(Ballsh). Nga Apolonia trangu kryesor i rrugës ndiqte rrëzën e kodrave deri në Frakull, hidhej më pas në Ferras dhe prej aty në Mifol, duke gjarpëruar në korridorin bregdetar deri në Aulona.

Dega veriore e rrugës “Egnatia” është më pak e njohur nga pikëpamja topografike. Sidoqoftë, dihet me siguri se, nga Dyrrakiumi nisej një rrugë që çonte në Lissus dhe më tej në Scodra, e cila përzgjatej në Doclea (Podgorica e sotme) përpara se të dredhonte drejt bregdetit dalmat deri në Narona dhe Salona (Spliti i sotëm). Në të kundërt, një degë e tretë synonte brendësinë e vendit ilir; ajo e merrte zanafillën diku përpara Klodianës dhe, pasi kapërcente lumin Genusus, kalonte në bregun përballë (fshati Thanas) dhe ngjitej në kodrat e skajit perëndimor të Dumresë për të rënë në Dushk, pranë Lushnjës së sotme; prej andej, duke ndjekur vijën e relievit, rruga synonte bregun e lumit Hapsos (Seman) dhe, në Kuç, ndiqte rrjedhën e Osumit deri në Antipatrea (Berat).

* * *

Tronditjet gjeopolitike në Ballkan, gjatë shekujve XIII-XV, si edhe fuqizimi i republikave detare: Republikës së Venedikut dhe asaj të Raguzës në këtë pjesë të Mesdheut, i shtynë tregtarët italianë në kërkim të rrugëve të reja drejt Maqedonisë, fillimisht më të shkurtra, por, para së gjithash, më të sigurta. Nga pikëpamja venedikase, kalimi përmes zonës katolike shqiptare (Mirditë) e jepte pak a shumë këtë siguri meqë bëhej fjalë për një territor “aleat”. Kjo ide ishte në origjinë të lindjes së një rruge tjetër - “Zentës”, ndoshta më pak e shquar, por po aq e vlefshme dhe e dobishme sa “Egnatia”. “Zenta” ishte një rrugë e vjetër këmbësore që lidhte dikur Scordën (Shkodrën) dhe Lissusin (Lezhën) me Ulpianën (Lipjanin e sotëm), thellë në tokat e Kosovës.

Mallrat, pasi shkarkoheshin në portin e Ulqinit në pjesën fundore të bregdetit dalmat, në portin e Obotit mbi Bunë dhe më në jug në Shëngjin pranë Lezhës, qendëroheshin në mënyrë krejt të natyrshme në qytetin e Shkodrës, metropoli i pjesës veriore të vendit dhe bazë e fuqishme tregtaro-ushtarake venedikase përgjatë shekujsh. Më tej, nga Shkodra, karvanët zbrisnin në fushën e Zadrimës dhe merrnin përpjetë luginën e Vigut, duke e shmangur kështu nga ana jugore malësinë e Lezhës (malet e Kushnenit dhe të Tërbunit) deri sa mbërrinin në luginën e hapur të lumit Fan. Në vijim, traseja e vjetër ndiqte shtratin e Fanit të Madh pothuaj deri në burimet e tij, duke e përshkuar në këtë mënyrë tejmbanë gjithë krahinën e Mirditës; pastaj kalonte në të vetmin shteg që çonte drejt lindjes, i cili përdorej pothuaj gjithë vitin - Qafa e Malit me një lartësi prej 964 metrash mbi nivelin e detit.

Nga ana veriore, në fund të honeve malore ku gjendet lugina e Drinit, kjo rrugë shmangej disa kilometra në verilindje të Fushë-Arrëzit, duke zbritur drejt

Kalimashit dhe më tej në Kukës. Në të vërtetë, lugina e Drinit të Mesëm, me një gjatësi prej gati 100 km mes Shkodrës dhe Kukësit, është e ndrydhur mes krahinës së Mirditës dhe asaj të Dukagjinit dhe gjithmonë ka pasur namin si e pakalueshme, prandaj duhej kryer gjithë kjo shmangie nga jugu nëpërmjet rrugës së Zentës. Në lartësitë e qytetit të Kukësit, pasi lë mënjanë korridorin jugor të Drinit të Zi, rruga e Zentës parapëlqente luginën komode të Drinit të Bardhë për të mbërritur në qytetin e Prizrenit, në skajin jugor të Rrafshit të Dukagjinit (Metohia). Duke përfituar nga terreni pothuaj i sheshtë i Rrafshit të Kosovës, rruga e Zentës hynte në qytetin e Suharekës; më tej, një qafë tjetër në lartësinë 912 metra ia hapte kalimin drejt Shtimljes, ndalesa e fundit përpara mbërritjes në Fushë-Kosovë dhe hyrjes në Ulpiana. Për ata udhëtarë që donin të zbrisnin drejt Shkupit, nëpërmjet grykës së Kaçanikut, kjo rrugë piquej me “*bulevardin*” transversal Moravë-Vardar, i cili lidhte Beogradin me Selanikun.

Në vitin 1912 rruga e Zentës u dha mundësinë serbëve të shmangnin pengesën natyrore që përbënte Malësia e Madhe dhe Dukagjini, me qëllim për të mbërritur në brigjet e Adriatikut dhe për të rrethuar Shkodrën, qytetin aq të lakmuar nga ky komb fqinj. Deri në vitet '90 të shekullit XX kjo rrugë e vjetër e kish humbur pothuaj tërë interesin e saj, me gjithë avantazhet praktike që ofronte në krahasim me simotrën e vet “Egnatia”.^{vii} Arsyeja kryesore e një qëndrimi të tillë është, pa dyshim, fakti se ajo përshkon krahinën e Kosovës, këtë mollë sherri mes fqinjësh të papajtueshëm. Lidhja mes dy vendeve bëhet nëpërmjet pikës kufitare të Morinës, fatkeqësisht aq e njohur gjatë luftës së Kosovës nga kalimi i dhjetëra apo qindra-mijëra kosovarëve të dëbuar me dhunë nga regjimi i Millosheviçit. Gjatë dhjetëvjeçarësh të tërë e vetmja pjesë e shfrytëzuar e kësaj rruge ishte ajo mes Fushë-Arrëzit në lartësitë e Mirditës dhe qytetit të Rubikut në luginën e poshtme të Fanit, e cila shërbente për transportin e lëndës së drurit dhe të mineralit të bakrit drejt industrive që gjendeshin në zonën fushore. Paslufta dhe statusi i ri ndërkombëtar i Kosovës e ringjalli interesin për këtë rrugë të vjetër, pasi ajo përfaqëson të vetmin kalim të krahinës drejt detit - nëpërmjet hapësirës ndërshqiptare.^{viii}

^{vii} Rruga e vjetër e Zentës përshkon gati 250 km mes Shkodrës dhe Shkupit, i cili përbën dhe pikën e saj të takimit me trasenë vertikale Moravë-Vardar; nga këta kilometra, 127 janë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Kësaj distance i duhen shtuar 215 km të tjerë autostradë mes Shkupit dhe Selanikut. Në të kundërt, rrugës “Egnatia” i duhen 382 km për të lidhur Durrësin me Selanikun, prej të cilëve 130 km në brendësi të territoreve shqiptare.

^{viii} Varianti modern i rrugës “Zenta” është *Rruga e Kombit*, segmenti i saj fundor orientohet natyrshëm drejt Tiranës dhe Durrësit. Në ndryshim me trasenë e rrugës së vjetër, pasi lë pas Rubikun dhe rrethqarkullon Rrëshenin nga veriperëndimi, rruga e re kalon nga lugina e Fanit të Vogël deri në afërsi të Kalimashit, prej andej, pasi përshkon një tunel me gjatësi 6 km, zbret në Kukës dhe rigjen shtegun e dikurshëm që çonte në Prizren.

Sikundër Durrësi dhe Shkodra, edhe Vlora, qyteti-port kryesor i Jugut të vendit, kish fituar të drejtën të ishte pikënisje e një rruge të vjetër, e veçanta e së cilës që përshkimi i gjithë bregdetit të Jonit dhe kalimi nëpër Epir, në vend që të futej në thellësi të vendit dhe të gadishullit. Kjo rrugë, gjithashtu e projektuar dhe e realizuar nga romakët, kishte kryesisht qëllime ushtarake; disa shekuj më vonë, në periudhën osmane, ajo ia detyroi famën e vet zhvillimit tregtar të qytetit të Janinës.

Nga ana tjetër, lugina e Aoos (Vjosës), megjithëse ofron një kalim më se të rehatshëm, çonte deri në Tepelenën e sotme. Më tej, meqë ngjitja drejt Këlcyrës dhe Përmetit të çon në Zagori, në mes të maleve të Pindit - rruga shmanget në mënyrë krejt të natyrshme dhe zgjedh kalimin po aq të qetë nëpërmjet luginës së Drinos, i cili zgjatet deri në Dropull. Duke lënë më të djathtë qytetin e Gjirokastrës, të ndërtuar në shpatin e Malit të Gjerë, dhe më të majtë qytezën e Libohovës, të ngritur në shpatin e Buretos përballë, rruga Vlorë-Janinë i afrohet kufirit të sotëm me Greqinë, të cilin e kapërcen në pikën kufitare të Kakavijës. Në këtë pikë të udhëtimit, rruga i braktis luginat dhe ngjit një qafë të parë prej 420 metrash mbi nivelin e detit, në lartësi të qytetit Dhelvinakion; më tej ngjit një qafë të dytë, përpara se të zbresë në pellgun e liqenit të Janinës dhe të hyjë në qytetin me të njëjtin emër. Traseja antike vazhdon drejt jugut dhe i drejtohet një qyteti tashmë të zhdukur - Nikopolis - nja 10-15 km në veri të qytetit të Prevezës.^{ix}

Pozita gjeografike tej e volitshme e Vlorës lejon vendosjen e një lidhjeje tjetër mjaft të rehatshme me brendësinë e vendit shqiptar: nëpërmjet degës jugore të rrugës "Egnatia", ajo siguron komunikimin me Apoloninë dhe, nëpërmjet përzgjatimit drejt Antipatreas, arrinte në Kuç, në bashkim të Osumit dhe Devollit. Duke ndjekur më pas rrjedhën e poshtme të Devollit, një udhëtim prej 44 km, ajo shpie në brendësi të krahinës së Sulovës, në Gramsh. Këtu rruga ndjek një kanion të vërtetë prej 53 km që çon në hyrje të pellgut të Korçës dhe, më tej, nëpërmjet fushës së Bilishtit, në Greqinë fqinje. Kjo rrugë e fundit, fort e vjetër dhe e përdorur nga bullgarët mesjetarë për të pushtuar Beogradin (Berat), si dhe në kahen tjetër nga normanët për të sulmuar Thesalonikan, u vu nën kontrollin bizantin qysh në shek. XII, dhe u rizbulua e u rindërtua pjesërisht nga italianët në prag të Luftës së Dytë Botërore, dhe u përdor gjatë sulmit të tyre ndaj Greqisë fqinje. Që prej asaj kohe, rruga e Devollit ra në harresë dhe u braktis përfundimisht; përdorimi i saj mbeti krejt i rastit, duke plotësuar kryesisht nevoja të natyrës strategjiko-ushtarake.

^{ix} Rruga Vlorë-Janinë përshkon 169 km, nga të cilët, 113 km në brendësi të territorit shqiptar. Për të mbërritur deri në Prevezë duhen përshkuar edhe 95 km të tjerë në kushte më se të rehatshme, në një zonë pothuaj krejtësisht fushore.

Vështrimi i tjetrit

Ata ushtarakë, fetarë, gjeografë dhe të tjerë udhëtarë, të ardhur në vend qysh prej kohëve më të lashta për të ngadhënjyer, pagëzuar, zbuluar ose përshkuar, vrojtuan banorët dhe eksploruan terrenin. Sipas epokës dhe mënyrës së vet, secili na ka lënë dëshmi, sipas përfytyrimit të tij për botën, dhe, në fund të fundit, secili prej tyre e pa qartë atë që kish dëshirë të shihte. Kështu, hyjnorët helenë hasën me barbarë ilirë, të egër dhe britës; falanga maqedonase u përball me enkelej luftarakë dhe taulantë këmbëngulës; legjionet romake shpartalluan ardianë krenarë dhe pirustë pothuaj të pamposhtur; apostulli Pal dhe dishepujt e tij pagëzuan paganë të përhumbur; gjakatarët gotë i masakruan deri më një autoktonët e romanizuar; sllavët këmbëngulës përthithën deri edhe ilirin e fundit; perandorakët bizantinë dalluan arbit e parë, ndërsa turqit osmanë arritën t'i mposhtnin dhe t'i bënin për vete shqiptarët trima.

Siç mund të pritet, vargu mbyllet me historianët shqiptarë, të cilët na sigurojnë se të gjitha këto shfaqje s'janë gjë tjetër, veçse aspekte të ndryshme të të njëjtit thelb: vazhdimësisë njerëzore, e cila provon autoktoninë e vendasve. Ndërkohë, në përputhje me bindjet dhe botëkuptimin filozofik e politik, ata e sintetizojnë *realitetin* historik dhe e paraqesin si realitet kohor objektiv, në themel të të cilës qëndron *ngjarja* - ndeshja, beteja, fitorja, kryengritja, marrëveshja - moment kulmor i rrugëtimit historik popullor, i cili u bindet ligjeve shoqërore. Pretendimet janë po aq të mëdha sa edhe vështirësitë e ndërmarrjes: pothuaj asnjëri prej tyre nuk i shpëton tundimit për ta shkruar historinë me H të madhe dhe, aq më tepër, në formë të shquar - *Historia e Shqipërisë*, *Historia e popullit shqiptar* - sikur të ishte e vetmja dhe e fundit në llojin e vet!

Cilado qoftë epoka, vështrimi i tjetrit mbi këtë grup njerëzor ka ruajtur një aspekt të pandryshueshëm, që njëkohësisht të sjell ndër mend diçka të egër, të paepur, rebele, të lirë... sikundër dhe origjinale, të varfër, të izoluar, për të mos thënë primitive. Një vështrim i magjepsur nga forca që çlirohet prej masës së maleve dhe karakterit të malësorëve. Për më tepër, në të tilla vise - Mesdheu dhe veçanërisht Ballkani njohin disa të tilla - "*shoqëria, qytetërimi, ekonomia, pra, çdo gjë mban vulën e arkaizmit dhe të pamjaftueshmërisë*"²⁸ ndërkohë që gjithçka në to mbetet e pakapshme, për t'u pushtuar, për t'u ringadhënjyer.

* * *

Malësor - ky cilësor i ka karakterizuar shqiptarët në jetë të jetëve. E, megjithatë, ata kanë privilegjin të lagen prej dy detesh nga më të përmendurit

e Mesdheut, t'i gëzohen një bregdeti të hapur, i cili ka disa porte të dorës së parë, të njohur prej kohësh të moçme.

Si shpjegohet atëherë që ky popull mbetet i maleve dhe jo i detit - në dallim të hapur nga fqinjin e tij jugor grek, fama e të cilit si lundërtar dhe detar i provuar ka zënë rrënjë qysh në lashtësi?

Mendimi i përgjithshëm është se ky popull parapëlqeu malet për hir të lirisë, të qëndresës; pra, për të qenë i pavarur, i ktheu shpinën detit, u izolua, duke u shndërruar, dashur pa dashur, në ishullor brenda tokës së thatë dhe, sipas kësaj logjike, del që sulmet dhe armiqtë vinin nga deti, nga Perëndimi.

Si bënte atëherë ky popull ndaj armiqve që vinin nga Lindja, nga prapatoka, nga luginat mes maleve, po aq vrastarë dhe gjakatarë sa edhe të parët, në mos edhe më tepër?

Në fund të fundit, përse shërbejnë spekulime të tilla përballë fakteve që flasin vetë? Shqiptarët e sotëm, sikundër edhe pararendësit e tyre të drejtpërdrejtë arbër ose të hamendësuar ilirë, kanë jetuar dhe jetojnë në një vend vërtet malor, por që, nga ana tjetër, ofron një ultësirë bregdetare, të pashoqe në të gjithë faqen perëndimore të gadishullit. Historikisht, zgjedhja e zonës kodrinore, e pllajave ose e gjysmëlartësisë nuk del të jetë frut i mbipopullimit as edhe i mbijetesës për t'iu larguar në mënyrë të qëndrueshme dhe përfundimtare rrezikut të huaj. Mjafton të kujtojmë se në ditën e pavarësisë, më 28 nëntor 2012, i tërë vendi numëronte më pak se një milion banorë dhe shumica e tyre banonte në thellësi të territorit, ndërsa ditët e sotme, vetëm pellgu Tiranë-Durrës, krejtësisht në ultësirën bregdetare, përmbledh mbi një milion veta, rreth një e treta e popullsisë së përgjithshme.

Në të njëjtën mënyrë sikundër natyra e varfër e Atikës i dënoi helenët të dilnin në det të hapur në kërkim të jetës, të mirëqenies - dhe së fundi, të lavdisë, po ashtu natyra e pamëshirshme e bregdetit tonë adriatik i detyroi arbitrit-shqiptarë t'u ngjiteshin maleve përtpjetë që të mbijetonin. Ata u syrgjynosën në brendësi të vendit, zgjodhën për vendbanim luginat, kodrat, pllajën apo malin, pasi ajo tokë pranë bregdetit vriste përpara se të ushqente.

Me të drejtë njeriu i druhej atmosferës mbytëse dhe helmatisëse të fushës bregdetare, ku mbizotëronin moçalet dhe kënetat, ku ta pinte gjakun kunupi, të merrte shpirtin malaria, ku të kalbeshin këmbët në ujë dhe vetëm disa pak për qind (8 ose 9%) e saj mund të kultivohej. Për më tepër, qytetet e vetme të kësaj zone - Durrësi, Vlora, Lezha - të ngritura në një brez të ngushtë toke ngjitur me detin - qoftë edhe Shkodra apo qytezat e tjera pranë liqenit, kanë ardhur deri në ditët e sotme si një trashëgimi e kohëve më të lashta. Ato kanë mbijetuar falë tregtisë dhe transportit, falë këmbënguljes të fuqive tregtare mesdhetare, që kanë bërë çmos për t'i mbajtur gjallë; fillimisht Korinti dhe Kërkyra antike, më tej Roma dhe Kostantinopoja, diçka më vonë Venediku... Ato nuk qenë kurrë plotësisht ilire, arbëre ose shqiptare, deri edhe pas shpalljes së pavarësisë së vendit në shek. XX.

Në të kundërt, të gjitha qytetet e tjera të vendit, të themeluara gjatë antikitetit të vonët dhe mesjetës së hershme - qendrat më të shquara të artit, të kulturës, të artizanatit - Berat, Elbasan, Krujë ose Gjirokastrë, janë ngritur pranë ose në shpatet e maleve që kufizojnë ultësirën perëndimore, e cila mbeti thuajse e braktisur për një kohë të gjatë; qytetet filluan të shfaqeshin në këtë ultësirë vetëm gjatë shekujve të fundit, pasi ndërhyrja njerëzore mundi t'i rrethqarkonte vatrat e infeksionit, t'i përmbante vërshimet e lumenjve, të kanalizonte ujërat e ndenjura. Kështu, lulëzoi Tirana rrëzë Dajtit, Lushnja nën hijen e Dumresë, Fieri në skaj të Mallakastrës... Çfarë duhet thënë për masën e fshatrave, të katundeve, të grupshtëpive apo kullave të vetmuara që ngrihen në kodra, kacavirren nëpër shpate, u ngjiten përpjetë luginave, preferojnë pllajata: pra, që i largohen bregdetit sikur të ishte murtaja? Një bregdet adriatik çuditërisht i shkretë prej Velipojës deri në Nartë, përgjatë dyqind kilometrash, i cili, përveç atyre tre-katër qyteteve njohura (Berat, Elbasan, Krujë, Gjirokastrë) dhe një Kavaje pak a shumë të re e cila e konkurren Durrësin në distancë, nuk ka njohur pothuaj asnjë fshat, asnjë qendër detare ose peshkatore.

I vetmi përjashtim që e vërteton rregullin, vjen nga Joni shkëmbor dhe, si pasojë, i kursyer nga kënetat dhe pellgjet bregdetare. Bëhet fjalë për fshatrat dhe qytezat e të ashtuquajturit "bregu": Dhërmi, Himarë, Qeparo, Borsh apo Piqeras, që, megjithëse të ngritura në shpat, e kanë orientuar jo vetëm pamjen, por edhe jetën drejt zanateve të detit: janë lundëtarë, peshkatarë, tregtarë.

Pra, shqiptari është një malësor i shtyrë kryesisht nga nevoja dhe jo nga dëshira; si pasojë, blegtor nga halli, druvar ose thëngjilltar nga sikleti, bandit ose ushtar nga e keqja... Në përputhje me imazhin që çliron vetë vendi - "*një fasadë bregdetare me një brendësi të tërë malore*"²⁹ shqiptari është, përfundimisht, detar më shumë për emër, tokësor me mish e me shpirt!

Duam apo s'duam ne, kjo mënyrë vështrimi e botës tradicionale shqiptare ndjek logjikën epistemologjike që e karakterizon një shkollë të tërë historiografike të gjysmës së dytë të shek. XX: ajo shprehet, para së gjithash, me ndërrimin e paradigmes historike. Thellësisht i pakënaqur me trajtën e "*historisë - manual*" në thelb të së cilës qëndronte "*ngjarja*", një grup historianësh arriti të mëtonte se lënda empirike me të cilën merren, vibron fillimisht me një ritëm fort të ngadalshëm, "*thuaj të pandryshuar*": ai i mjedisit gjeografik, i *strukturave* dhe, nëse ky zanafillë në viset tona e njeh mjeshtërinë, ajo ka të bëjë, mes të tjerash, me të shpjeguarit e mënyrës me të cilën ky mjedis - i ngjan gjithmonë atij territori të parë, ashtu siç e zbuluan helenët apo romakët e parë dhe siç e lanë bizantinët e fundit, pra, të njëjtat male, lumenj ose liqene, të njëjtat dete që lagin brigjet - u imponohet dhe gdhend fytyrën e grupeve njerëzore, që jetuan në të, sikundër dhe mënyrën e këtyre të fundit për t'i përvetësuar dhe t'iu kundërvënë strukturave, për të farkëtuar qenien e tyre, po ashtu dhe shprehjet e saj të shumëfishta - *koniunkturat*.³⁰

Mbivënja e koniunkturave mbi strukturat nënkupton se frekuenca e ngadaltë e strukturave modulohet nga frekuenca e mesme e koniunkturave - mënyrat e organizimit të botës shpirtërore, të marrëdhënieve shoqërore, të ndërthurjeve politike apo ushtarake dhe, së fundi, të prodhimit të vlerave materiale apo kulturore - gjithçka kontribuon në ngjizjen e *qytetërimeve*, që rrënjosen mbi hapësirat e përcaktuara dhe përcaktuese gjeografike. Pikërisht në linjën e thyerjes së ekuilibrave koniunkturorë, të rikompozimit të tyre pas një krize simptomatike shfaqet *ngjarja*, e materializuar, e personifikuar, e përcjellë dhe e mbajtur mend nëpërmjet njeriut - hero. Në këtë mënyrë, roli i individit duhet këqyrur jo më si ai i agentit të historisë, por si roli i aktorit të skenës, qoftë edhe kryesor. Çka mbetet e hapur në këtë skemë, është marrëdhënia e ndërsjellë dhe bashkaktive mes elementit ngjarje dhe sistemit që e prodhon, i cili, si çdo sistem tjetër, nuk është as i paracaktuar, as edhe paracaktues, por rastësor: *dialektika ngjarje - sistem*.

Kjo marrëdhënie rrethqarkore është jashtëzakonisht mësimprurëse për historianin e zanatit; koncepti i "krizës" mund të rimerret jo vetëm për arsye të raportit me anë të ciklit apo të përsëritjes, por pikërisht për arsye të funksionit të tij shfaqës lidhur me paqëndrueshmërinë e sistemeve sociale dhe përshtatshmërisë së tyre ndaj vetive shpërbërëse/ rindërtuese, karakteristike të krizës: "Një shoqëri e cila zhvillohet, është një shoqëri që shkatërrohet për t'u rindërtuar, pra, është një shoqëri që i vetëshumon krizat." Kështu rehabilitohen aspektet shekspiriane të një historie të ngritur mbi zhurmën dhe tërbimin, e cila i vërteton, madje me tepriçë, nëse guxojmë të themi, përçudnitë dhe shtazëritë e shek. XX.³¹

Koncepti braudeliani i "kohës" dhe airikoeriani i "ngjarjes" më kanë ndikuar thellësisht në konceptimin e këtij libri - dhe përfitoj nga rasti të theksoj me forcë, se ai nuk është aspak një përpjekje për të rishkruar Historinë, sikundër është moda e kohës të sotme. Për arsyen e parë dhe të vetme se ai nuk është një tekst i mirëfilltë historie, paçka se historia e shqiptarëve dhe e Shqipërisë përbën indin e tij.

Libri duhet këqyrur dhe mundësisht duhet pranua, si një rrëfim mbi vendin dhe rrethqarkun e tij përgjatë shekujve. Më tej, ai duhet lexuar si sprovë për të kuptuar ritmet e historisë, për të analizuar ndërthurjen e tyre, me qëllim krijimin e perspektivës historike të grupeve dhe vijëzimin e trajektores njerëzore. Me pak fat, ai mund të konsiderohet si një përçapje e domosdoshme nga ai rreth lexuesish, të cilët, njëkohësisht, interesohen për të shkuarën si të tretur në përvojën e të sotmes dhe shqetësohen për të ardhmen si kanalizim për vetë të sotmen.

*"Hapësira e përvojës nuk mjafton kurrë për të përcaktuar një horizont priteje."*³²

* * *

Gjenia njerëzore ka nuk ka reshtur në këmbënguljen e saj për ta shndërruar peizazhin, duke e këmbyer përpjekjen e ngadalshme ndërtuese me tërbimin e shpejtë shkatërrues, dhe ka arritur veçse ta shndërrojë vetveten dhe, si rrjedhim, të ripozicionohet lidhur me Tjetrin. Vetëm në këtë mënyrë mund të kuptohet ndryshimi i vazhdueshëm i referencave gjeografike të vendit, në gjirin e asaj kozmografie të çuditshme njerëzore që klasifikon vlerat e qytetërimeve në funksion të drejtimeve kryesore të horizontit: veri, jug, lindje, perëndim.

Për një kohë të gjatë, e pavetëdijshme ndaj faktit se jeton nën një lloj sferë qiellore, urtësia e hershme njerëzore e rrethqarkut mesdhetar, sidoqoftë, ka mundur të përcaktojë logjikën e një korrelacioni të parë mes boshtit Veri-Jug, klimës dhe shkallës së zhvillimit të një shoqërie njerëzore: Veri = terr, acar = fise dhe klane barbare; Jug = dritë, ngrohtësi = qytetërime rrezatuese.³³ Një imazh i tillë plotësohet dhe pasurohet ndërkohë që tregtia shndërrohet në një formë shkëmbimi po aq të rëndësishme sa edhe lufta në gjirin e shoqërive pagane, madje edhe politeiste. Historia na jep shembujt, gjeografia na paraqet hartat dhe autorët e lashtë sjellin dëshmitë e tyre më të mira.³⁴

Paçka se Egjipti i lashtë, i lagur nga Nili dhe i verbuar nga dielli i Faraonit, nuk ka qenë tunduar nga vizione të tilla - ndoshta ngaqë lugina e Nilit përfaqësonte qendrën e botës dhe krejt rrethqarku mbetej në hije; Greqia e lashtë, e sunduar nga policentrizmi i qyteteve-shtete, po aq tregtare sa edhe luftëtare, e bëri të vetën si një përfaqësim të botës së saj dypolëshe. Vetëm se Veriu i egër i grekëve shtrihet andej nga fryn *borea* - era e akullt e dimrit, menjëherë përtej zonës ku flitej greqisht. Roma republikane e ndjekur nga Roma perandorake krijoi një tjetër vizion etnocentrik si vlerë universale: duke qenë qendra e botës së qytetëruar, e gjithë periferia e saj, ende e paromanizuar, u asimilua me një hapësirë barbarizuese, e cila duhej të qytetërohej me të gjitha mjetet.

Me gjithë forcën përgjithësuese, përfytyrimi njerëzor e ka pasur gjithmonë të vështirë të përzgjedhë shenjat dhe simbolet për t'u orientuar në aksin tjetër Lindje - Perëndim: dielli që lind mbi një mal - gjithmonë i ndryshëm, në vartësi të vetë vëzhguesit - ose që shkon dhe zhduket diku në det - në cilin det?! Ata që e kanë ndjekur me sy, nuk janë në gjendje të përgjigjen me saktësi. Sikundër edhe arabët, të cilët e quajtën horizontin e përflakur *ereb* = "*aty ku perëndon dielli*".³⁵

Kjo dykuptimësi jashtëpersonale mund të zhdukej veçse nëpërmjet përcaktimit të një orientimi të ri, të një logjike jashtëkohore, rolin e së cilës e luajti feja e krishterë. Me të vërtetë, pas pagëzimit të perandorit Kostandini i Madh në vitin 312 dhe shpalljes së Ediktit të Selanikut nga Teodosi I në

vitin 380, që vuloste aleancën e shenjtë mes fesë së re të krishterë dhe shtetit romak të personifikuar nga perandori, njerëzimi mbarë duhet të ketë lëshuar një psherëtimë të thellë çlirimi dhe kënaqësie. Tashmë me Kostandinopojën si qendër e botës së qytetëruar, Roma ndodhej në perëndim (të Kostandinopojës) dhe Jerusalemi në lindje. Por edhe ky sistem nuk mundi t'i shpëtonte vesit: mjaftoi që Roma të ngrihej në një qendër të pavarur dhe aq e fuqishme sa të eklipsonte Kostandinopojën, dhe menjëherë një krah i tërë i botës së vjetër (bashkë me Kostandinopojën) u internua në lindje.

Vertikalja imagjinare e Shën Agustinit, e cila njëkohësisht lidhte dhe dallonte *Qytetin e Zotit* me *Qytetin e Tokës*, u qendërzua në sheshin e katedrales Shën Pjetër në Romë. Ajo përfaqëson edhe linjën e parë të vërtetë që e ndau më dysh Europën tonë të vjetër. Pra, meqenëse tashmë dielli i Kishës katolike qëndron gjithmonë në zenit, ai krah i botës ku, njëherë e një kohë, dielli i qiellit shkonte të perëndonte pas një dite të lodhshme - *occidensi* i romakëve shndërrohet në oksident, ndërsa lindja - *oriensi* mbetet orient. E gjithë përpjekja e mëvonshme s'është gjë tjetër, veçse çështje kufijsh: nga njëra anë, vendosja e kufijve të rinj brenda hapësirës së vjetër, duke i ndarë me këtë rast shtetet dhe, nga ana tjetër, shtyrja sa më larg e kufijve të njohur të botës. Në këtë mënyrë, Oksidenti shtrihet edhe më tej në perëndim, ndërkohë që Orienti shtyhet gjithnjë e më larg drejt lindjes - me atë vijë ndarjeje mes këtyre dy botësh, e cila përshkon jo vetëm hapësirën, por edhe kohën për t'u imponuar si një pengesë virtuale e, dora-dorës, si një mur ose si një *perde e hekurt* e cila gjithmonë i ka ndarë kulturat, ideologjitë, sistemet politike dhe, në fund, vetë njerëzit.

Ky vend, i cili na intereson kaq tepër, gjendet fare pranë Romës, por gjithmonë në lindje të saj. Me këtë rast, ai i përket lindjes-Orient, apo perëndimit-Oksident?

Historia sjell mjaft elemente për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje; shoqëria sjell të tjera argumente, mendësia e njerëzve gjithashtu mund të ndriçojë aspekte të veçanta, ndërkohë që kuadri gjeografik, brenda të cilit rrethshkruhet ai, nuk ka ndryshuar dhe nuk ka për t'u ndryshuar kurrë. Ai mbetet njëkohësisht pjesë përbërëse e botës mesdhetare - e pjesës së saj lindore - dhe e familjes ballkanike, anëtar i saj më perëndimor. Duke qenë një element i këtij kompleksi - sigurisht original dhe jetësor, por, sidoqoftë, një element i pafuqishëm - atij i është dashur t'u nënshtrohet të papriturave të historisë, të imponuara nga fuqitë ushtarake apo ekonomike të pellgut ose të rajonit. Ja përse përgjigjja ndaj pyetjes së mësipërme nuk është as gjithmonë e njëjtë, as edhe përfundimtare, mjafton të ndiqet realiteti përgjatë shekujve: vendi i përkiste sferës perëndimore në kohën e romakëve, sferës lindore në kohën e bizantinëve, përsëri perëndimit gjatë ofensivës mesjetare latine, edhe një herë lindjes në epokën e osmanëve. Me fjalë të tjera, qysh prej kohësh të lashta vendi është përfshirë në një luhatje ciklike ndërmjet Perëndimit dhe

Lindjes, frekuenca e së cilës matet me shekuj të tërë. Për syrin e historianit vendas, elementi më qenësor i popullit që ka banuar në këto vise, ka mbetur qëndresa ndaj pushtuesit, shpirti i tij i paepur luftarak. Ky fill i kuq përshkon kohërat dhe shndërrohet në një natyrë të dytë; heroizmi popullor përbën indin e qenies së tij të lavdishme, ndërkohë që gjaku i derdhur ngjyrosi flamurin e tij kombëtar. Duke u rezistuar armiqve të panumërt, ky komb i ka rezistuar njëkohësisht edhe kohës: në këtë mënyrë, ai ka mbërritur deri në ditët e sotme dhe shpalos të gjitha karakteristikat e tij të papërsëritshme.

E megjithatë, përtej imazhit vetëlavdërues, skicohet një element tjetër po aq qenësor sa edhe i pari: në qoftë se qëndresa përbën faqen e sipërme të medaljes, përzgjatjen e natyrshme të çdo agresioni, ajo nuk ka mundur ta shmangë as pushtimin, as edhe instalimin e makinës së huaj, përpjekja kryesore e të cilës gjithmonë ka mbetur përfshirja e burimeve materiale dhe njerëzore të vendit, në gjirin e një sistemi vlerash. Pas agresionit, luftës, jetës në lavdi, vjen pushtimi, nënshtrimi - jeta e zakonshme. Pra, mbijetesa e atij populli sikundër dhe e gjithë popujve të tjerë europianë është, para së gjithash, bashkëjetesë - ja, edhe faqja e prapme e medaljes. Magjia që çlirohet nga ajo tablo e paharruar ku një populli i vogël - David, përball agresorin e përbindshëm - Goliath, mund të funksionojë vetëm atëherë kur ndërgjegjja dhe nënndërgjegjja ta pranojnë se, pas djaloshit, qëndron Hylli; fillimisht ai i jep misionin dhe më tej bekon edhe dorën e bariut. Në këtë pikë, realiteti ndryshon nga legjenda: paçka nga bekimi i Hyllit, Davidi ynë e përfundon betejën duke përqaftuar fenë e pushtuesit. Historia ka mbajtur mend islamizimin e Shqiptarëve, ndërkohë që pothuaj ka harruar se ilirët e braktisën paganizmin për t'u kthyer në fenë e krishterë të romakut Shën Pjetër, se ilirët e fundit, gati të romanizuar, zgjodhën ritin lindor nën ndikimin e bizantinëve; se arbrit u kthyen rishtas në katolikë nën nxitjen e latinëve... e gjitha kjo përpara se shqiptarët të përfundonin në myslimanë nën trysninë e turqve osmanë.

Përballë ndryshuesve që ofron historia (përkatësia Perëndim - Lindje, larmia e zgjedhjeve fetare), gjeografia përcakton të vetmen konstante përgjatë mijëvjeçarësh: përkatësinë në Gadishullin Ballkanik. Mjafton emri i këtij të fundit për të të shtënë dridhmat, aq i ndërlikuar është kuptimi i tij dhe i hapur ndaj interpretimeve, aq të rënda janë edhe kontradiktat që bart ai në vetvete³⁶.

Veçse kjo urë kalimi mes Perëndimit dhe Lindjes, ky udhëkryq kontinental s'është gjë tjetër, veçse djepi i qytetërimit europian; kjo sallatë popujsh, ky *melting-pot* i kulturave përbën humusin e njerëzimit mbarë; kjo *fuçi baruti* e Europës, kjo *arenë ndeshjeje* e Fuqive të Mëdha përbën njëkohësisht pasqyrën ku reflektohet njëfarë ndërgjegjeje e fëlliqur kontinentale dhe spektrin e pasioneve më atavike, që ndriçojnë natyrën e Njeriut. Pa Ballkanin dhe ballkanasit, mes të cilëve identifikohet Shqipëria dhe shqiptarët, Europa nuk do të ishte kurrë ajo që është sot.

Shënime për PRELUDIN

1. Nga pikëpamja gjuhësore, emërtimi “Ballkan” i këtij territori gadishullor të Europës Jugperëndimore mund të konsiderohet si një *polisemí* - karakteristikë e një fjale me dy apo më shumë kuptime të mundshme (në rastin tonë: vargmal dhe gadishull), apo si një *metonimí* - shkarje e kuptimit nga një pjesë drejt së tërës. Nga ana tjetër, qoftë pjesa (vargmali), ose e tëra (gadishulli) në trajtën e tyre të sotme *Ballkan* paraqiten si *neologjizma* lidhur me kujtesën e lashtë njerëzore të banorëve të këtyre viseve.

Në të vërtetë, vargmali i vjetër qendror, i cili e përshkon Bullgarinë e sotme nga perëndimi në lindje (*Stara Planina* e bullgarëve), quhej *Aiuoç*-Ajmos nga helenët e vjetër dhe dhe *Hæmus* nga romakët, sipas emrit të tij trak. Nën ndikimin e dukshëm helen, bizantinët e quanin Ajmos - *Emon*. Mendohet se kjo trajtë e fundit qëndron në origjinë të emërimit turk-osman - *Emine*, si pjesë e togfjalëshit *Emine-balkan*, me të cilën turqit osmanë e pagëzuan fillimisht vargmalin, qysh në momentin kur u doli përpara syve; ndoshta dhe, me besim te historiani turk Inalçik, duke i bashkëngjitur Emines fjalën tjetër iraniano-turke *balk* - baltë.

Duke folur gjithmonë për vargmalin, sidoqoftë, fjala turke “*ballkan*” shfaqet për herë të parë në shkrimet e udhëtarëve europianë të shekujve XVI dhe XVII, fillimisht si sinonimi osman i emrit të vjetër *Hæmus*. Me kohë, veçanërisht në shek. XIX, ajo u bë e gjithëgjendur deri sa arriti ta zëvendësonte plotësisht referencën antike.

Lidhur me vetë gadishullin, emërtimi i tij “*ballkanik*” del për herë të parë në fillim të shek. XIX, në veprën e gjeografit gjerman August Zeune. Deri asokohe historianët dhe gjeografët parapëlqenin të përdornin emërtimet antike ose mesjetare: “*helen, ilirik, dardan, roman, bizantin*” ose “*trak*”, madje edhe gjatë shekullit në fjalë, të tjerë gjeografë përdorën pa ngurrim emërtimin “*Turqia europiane, Lindja europiane, Europa orientale*” ose “*gadishulli sllav i Jugut*”, ndërsa vetë turqit e quanin atë *Rumeli* - toka e Rumi (e romanëve), deri edhe *Europa osmane*. Diskutimi lidhur me përzgjedhjen e emërimit të duhur vijoi deri në fillim të shek. XX, me këmbënguljen gjermane të përdorimit të shprehjes “*Europa Juglindore*”, i nxitur nga konfuzioni ndaj përcaktimit të “*kufijve*” veriorë dhe verilindorë të gadishullit.

Përfundimisht, nën shembullin e literaturës të shfletuar dhe të cituar, paçka nga periudha e këqyrur historike në kuadrin e këtij libri, ky gadishull është quajtur apo cilësuar vijueshmërisht dhe, pa asnjë ngurrim, *Ballkan* dhe *ballkanik*. Aq më tepër kur, qoftë Iliria, qoftë Arbëria apo, së fundi, Shqipëria, sikundër dhe masa njerëzore në përbërje të tyre, janë përfshirë gjithmonë brenda “*kufijve*” të tij natyrorë, sado të ngushtë të jenë përfytyruar ata. Në këtë kuadër, *anakronizmi* i gjykimit sikundër dhe çdo lajthitje në emërtim mbeten thjesht përgjegjësi e Autorit. Për më tepër lidhur me Ballkanin si emërtim - *nomen*, shih: Maria TODOROVA - *Imagining the Balkans*, Oxford University Press, Inc., NY 2009.

2. Në mjedisin e specialistëve, shifrat e lartpërmendura nuk janë gjithmonë unanime. Kështu, nëse i besojmë gjeografit Anderson, kufiri me ish-Jugosllavinë shtrihet në rreth 438 kilometra, ndërsa, sipas dokumenteve të Departamentit të Shtetit të ShBA-së, gjatësia e kësaj vije kufitare (bashkë me ujërat e brendshme) është 291 milje ose 468 km. Shih : The

Geographer - *International Boundary Study: Albania - Yugoslavia Boundary* No. 116 , Office of the Geographer, Bureau of Intelligence and Research, Department of State USA, 1971 ; The Geographer - *International Boundary Study: Albania - Greece Boundary* No. 113 , Office of the Geographer, Bureau of Intelligence and Research, Department of State USA, 1971 ; Ewan W. ANDERSON - *International Boundaries: A Geopolitical Atlas*, Routledge , London 2002.

3. Shih : Mevlan KABO & etj. - *Gjeografia fizike e Shqipërisë: Vol. I dhe II*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 1991.

4. Një vështrim më analitik nxjerr në pah faktin se njësitë e mësipërme gjeologjike grupojnë disa nënzona me karakteristika të ndryshme stratigrafike. Kështu, Albanidet e jashme përfshijnë: **1-** nënzonën e Alpeve shqiptare në skajin verior të vendit, të përbërë kryesisht prej flyshit të ri dhe shkëmbinjve gëlqerorë; **2-** nënzonën joniane, e cila mbulon thuajse gjithë pjesën jugore, një taban i vjetër evaporitesh (shkumësi), i mbuluar nga një shtresë më e re gëlqerorësh dolomitikë mbi të cilën janë depozituar shtresa molase prej flyshi argjilor ose lymor; **3-** nënzonën e fundosjes periadriatike, një platformë e rrudhur me natyrë karbonatike dhe dolomitike, e mbuluar nga një shtresë të trashë molase me përmbajtje shtufi ranor, shisti dhe lymi të mineralizuar, si dhe sedimente të tjera terrigjene me natyrë aluviale; **4-** nënzona e Sazanit (Karaburunit), kryesisht e përbërë nga shkëmbinj gëlqerorë dhe dolomitikë.

Rolin e brezit ndarës mes dy njërive strukturore e luan *nënzona e Krujës*, një brez i ngushtë, i përbërë kryesisht prej flyshi të vjetër dhe shkëmbinjsh karbonatikë, që përshkon gjithë vendin me orientim veriperëndim - juglindje, e cila mbimbulohehet pjesërisht nga *nënzona brezore e Krastë-Cukalit* me të njëjtin orientim hapësinor, gjithashtu e përbërë nga flyshi, por me moshë më të re. Këto dy nënzona shërbejnë edhe si breza ndarës me Albanidet e brendshme, që përmbajnë gjithashtu disa nënzona karakteristike. Mes tyre janë: **1-** *nënzona e Korabit*, formacioni më i vjetër gjeologjik i vendit, i përbërë nga një bazë konglomerate prej gresi, shistesh dhe gëlqerorësh, mbi të cilin gjenden të tjera shiste dhe anhidride më të reja, ku vërehen ndërfaqe shkëmbinjsh me origjinë vullkanike të natyrës bazike apo acide; **2-** *nënzona e Mirditës* me një shtrirje të gjerë nga veriperëndimi në juglindje, përbën një brez të gjerë me sipërfaqe 4.000 km² dhe me trashësi disa kilometra, e karakterizuar nga prania masive e shtresës ofiolite në faza të ndryshme shtresore, rezultat i aktivitetit vullkanik nënujor dhe i zhvendosjes së pllakave kontinentale, mbi të cilën vërehet një mbulesë shkëmbore ultramafike sikundër dhe shtresëzime flyshi apo molase; **3-** *nënzona e Gashit* në skajin verilindor të vendit, e përbërë nga struktura bazë terrigjene, mbi të cilat mbështeten shtresa sedimentare vullkanike me ndërfaqe shkëmbinjsh acidë.

Për më tepër lidhur me karakteristikat e zonave dhe të nënzonave gjeologjike të Albanideve, mes të tjerash, shih : Alfred FRASHERI & al - *Geophysical outlook on structure of the Albanides*, Journal of the Balkan Geophysical Society, Vol. 12, No. 1, December 2009 ; Telo VELAJ - *Tectonic style and hydrocarbon evaluation of duplex Kruja zone in Albania*, NAFTA 63 (7-8) 2012 ; Thomas DESCHAMPS - *Structure et Stratigraphie de la Zone de Korabi des Albanides Internes, Région de Kukës, Albanie*. Mémoire de Maîtrise, Université du Québec à Montréal, janvier 2009 ; Ilir KANE & al. - *The structure of the ophiolitic belt in Albania inferred from geomagnetic anomalies*, Annals of Geophysics, Vol. 48, N. 2, April 2005 ; Jean-Jacques DUFAURE & al. - *Tectonique et évolution géomorphologique : l'exemple du bassin de Korçë (Albanie)*. në: Géomorphologie : relief, processus, environnement , vol. 5, n°2, juin 1999.

5. Mbi këtë temë, shih : Sabri LACI - *Potentiel Naturel et Agriculture*, Në :F. LERIN & Ardian CIVICI (ed.) - *Albanie : une agriculture en transition* -, CIHEAM Option Méditerranées, Série B, n° 15, 1997.

6. Ligji i mbrojtjes së mjedisit i Republikës së Shqipërisë i rendit zonat e mbrojtura natyrore në 6 kategori: 1- Rezerva natyrore strikte/rezervat shkencor (2 syresh); 2- Park kombëtar (15 syresh), 3- Monument natyre (348 biomonumente, 398 gjeomonumente dhe 4 hapësira); 4- Rezervat natyror i menaxhuar/park natyror

rajonat (23 syresh); 5- Peizazhi i mbrojtur (5 syresh); 6- Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara (4 syresh). Sipërfaqja e përgjithshme e vënë kështu nën mbrojtje është 460.000 hektarë. Tanimë zonave dhe objekteve të mësipërme u shtohen edhe 4 “zona të lagura me rëndësi ndërkombëtare”, të vëna nën mbrojtje në bazë të Konventës RAMSAR të vitit 1971, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 98.200 hektarësh. Shih: www.mjedisi.gov.al/programi/biodiversiteti-dhe-zonat-e-mbrojtura.

7. Lidhur me pellgun dhe rajonin e Korçës, shih: Jacques BOURCART - *Les Confins Albanais Administrés par la France (1916-1920): Contribution à la Géographie et à la Géologie de l'Albanie Moyenne*, Editions Delagrave, Paris 1922; sikundër dhe: Jean-Jacques DUFAYRE & al. - *Tectonique et évolution géomorphologique: l'exemple du bassin de Korçë (Albanie)*. në: *Géomorphologie: relief, processus, environnement.*, vol. 5, n°2, juin 1999.

8. Shih : D. ARIZTEGUI & al - *Natural and human-induced environmental change in southern Albania for the last 300 years — Constraints from the Lake Butrint sedimentary record*, *Global and Planetary Change* 71 (2010).

9. Udhëtari i huaj që zbriste në bregdetin shqiptar, jo më larg se fillimi i shek. XX, vërente “një rrip kënetor, të drithëruar nga ethet, të shkretë, i cili ndante tokën nga deti. Laguna, kripore, kallamishte, degë dhe shtrate lumenjsh të vdekur; malarja këtu është zot, ethja e Bunës; qytetet u largohen këtyre brigjeve që qelben erë; ato strehohen në toka më të thata, pranë ujërave më të pastra, që rrjedhin nga malet e afërta”. Shih : Jacques ANCEL - *Peuples et nations des Balkans*, éd. de C. T. H. S, Paris, 1930 (ribotim, 1992).

10. Për më tepër lidhur me ekosistemet e lagunave dhe ligatinave bregdetare, shih : Evis TASKA & al. - *Limnologic Individuality and Esthetic Natural Values of Karavasta Hydrographical System (Albania)*, International Conference MarCoastEcos2012, Tirana, Albania, 25-28 April 2012 ; Anila SHALLARI - *Les zones humides d'Albanie. Transmission des normes internationales et européennes en matière environnementale en Albanie et dans les Balkans Occidentaux. Le cas de cinq zones humides : Shkodra, Karavasta, Narta, Butrinti et Prespa*. Doctorat de l'Université Paul-Valéry - Montpellier III, 2013 ; Mirela TASE - *Aspekte gjeomorfologjike të zonës bregdetare ndërmjet grykëderdhjes së lumit Buna dhe Kepit të Rodonit*, dizertacion doktorate, Universiteti i Tiranës, 2014.

11. Shih : Instituti Hidrometeorologjik - *Klima e Shqipërisë*, Tiranë, 1978.

12. Diferenca tepër të ndjeshme temperaturash vërehen në zonat e brendshme veriore dhe jugore të vendit, sikundër edhe në skajet e ultësirës perëndimore. Kështu, temperaturat e skajshme të matura në Tropojë shkojnë nga +36.5°C në -18.5°C; në Kukës këto vlera luhaten nga +39.5°C në -21°C; në Çorovodë nga +42°C në -13.5°C dhe në Ersekë nga +35°C në -20°C. Këtij fenomeni nuk i shpëtojnë as qytetet që gjenden në lartësi të ulët siç është Shkodra, ku janë matur temperatura +40°C dhe -13°C ose Tepelena (+41°C, -10°C). Shih mbi këtë çështje : Agim SELENICA, Marc MORELL (bot.) - *Les Ressources en Eau en Albanie*, doc. Provisoire, Montpellier déc. 2000.

13. Shih : Miron NURI - *Water and Climate Resources of the Adriatic Albanian Coastal Area*, Në: Conseil de l'Europe - *La protection des espaces côtiers de la mer Adriatique*: Actes; Tirana 1994.

14. Për sa i përket maksimumit absolut të reshjeve gjatë 24 orëve, rekordin e mban lokaliteti i Bogës në Alpet Veriore me 420 mm/m². Por nuk janë të rralla as zonat ose qytetet që kanë njohur të tilla rrebeshe, p.sh.: Puka me 204 mm, Shkodra me 135 mm, Bajram Curri dhe Burreli me 148 mm, Tirana me 112 mm, Çorovoda dhe Përmeti me 136 mm, Tepelena me 110 mm. Shih : Agim SELENICA, Marc MORELL (bot.) - *Les Ressources en Eau en Albanie*, doc. Provisoire, Montpellier déc. 2000 (cituar më lart).

15. Për gjeografin, lumenjtë ballkanikë bëjnë pjesë në ato pengesa të ngritura nga natyra për të vënë në provë gjeninë njerëzore: “Çfarë mund të përfitosh nga këta përrën timerë, me ujërat e tyre të tërbuara, që tërheqin gurë, zhavorr dhe rërë, të cilët mpaken në një fjollë uji

që rrjedh me përtësë mes gurëve të rrumbullt të shtratit?» Shih : Jacques ANCEL - *Peuples et nations des Balkans*, éd. de C. T. H. S, Paris, 1930 (cituar më lart).

16. Shih : Raymond ZICKEL & Walter R.. IWASKIW (bot.) - *Albania: A Country Study*, Washington, DC: Library of Congress, Federal Research Division. 1994.

17. Për më tepër lidhur me natyrën gjeologjike dhe klimatike të ekosistemit të liqeneve juglindorë, shih : B.WAGNER & T. WILKE - *Evolutionary and geological history of the Balkan lakes Ohrid and Prespa*, Preface, Biogeosciences nr. 8, 2011 ; Klaus REICHERTER & al - *Active basins and neotectonics: morphotectonics of the Lake Ohrid Basin (FYROM and Albania)*, Z. dt. Ges. Geowiss., 162/2, Stuttgart, June 2011 ; Konstantinos PANAGIOTOPOULOS - *Late Quaternary ecosystem and climate interactions in SW Balkans inferred from Lake Prespa sediments*, Dissertation zur Erlangung des Doktorgrades der Mathematisch-Naturwissenschaftlichen Fakultät der Universität zu Köln, 2013.

18. Shih : Kolektiv (Grup) autorësh - *The Strategic Action Plan (SAP) for Skadar/Shkodra Lake Albania & Montenegro*, Raport, april 2007.

19. Shih : Mario PARISE & al - *Natural and anthropogenic hazards in karst areas of Albania*; në: *Natural Hazards and Earth System Science*, nr. 4, 2004.

20. Shih : Romeo EFTIMI - *Hydrogeological characteristics of Albania*, Aqua Mundi : Journal of Water Science, 2010.

21. Shih : Romeo EFTIMI - *Investigation about recharge sources of Bistrice karst spring, the biggest spring of Albania, by means of environmental hydrochemical and isotope tracers*; Në: *Sustainability of the Karst Environment Dinaric Karst and Other Karst Regions*, International Interdisciplinary Scientific Conference, Plitvice Lakes, Croatia 2009; sikundër dhe : Romeo EFTIMI & Jovan ZOTO - *Isotope study of the connection of Ohrid and Prespa Lakes*: Në: "Towards integrated conservation and sustainable development of transboundary Macro and Micro Prespa lakes" - Korca, Tirana, 1996.

22.. Shih : Neki FRASHERI, Niko PANO & al. - *Outlook on Seawaters Dynamics Factors for the Albanian Adriatic Coastline Developments*, European Geosciences Union General Assembly, Vienna, 2011.

23. Pa asnjë mëdyshje, rruga "Egnatia" u rizbulua, u rindërtua dhe u shfrytëzua nga romakët për qëllime të natyrës ushtarake, si rruga më e shkurtër tokësore, që lidhte Gadishullin Italik me Maqedoninë, Greqinë dhe, më tej, me Bizantin.

Në të vërtetë, në rolin e urës lidhëse mes Lindjes dhe Perëndimit, Gadishulli Ballkanik ofronte rrugë të tjera natyrore, sigurisht më komode, të njohura dhe të shkelura qysh në agim të shtegtimeve të mëdha njerëzore që, me pikënisje Azinë e Vogël ose stepat e Vollgës, patën tronditur Europën mbarë. Një rrugë e tillë ishte vetë shtrati i Danubit, i cili lidh bregun e Detit të Zi me zemrën e Europës. Një tjetër rrugë e orientimit jug - veri, po aq e natyrshme, sa edhe e lashtë, ishte ajo që e merrte pikënisjen nga Thesalonika maqedonase (Selaniku) në detin Egje dhe ndiqte rrjedhën e sipërme të lumit Vardar deri në Skup (Shkup), për t'u hedhur në Dardaninë e asaj kohe nëpërmjet grykës së Kaçanikut dhe për të mbërritur në rrjedhën e epërme të Moravës. Pra, mjaftonte të ndiqej Morava dhe të kalohej përmes Naisus (Nish) për të mbërritur në Viminacium (Kostolac) mbi Danub.

Një tjetër rrugë e brendshme, e cila e përshkonte gadishullin nga veriperëndimi në juglindje dhe anasjelltas, e shfrytëzuar nga romakët dhe të tjerë barbarë, ishte e ashtuquajtura *via Militaris (Diagonale)*, me zanafillën në Sirmium (Sremska Mitrovica) mbi lumin Sava, ajo drejtohej nga Singidunumi (Beograd) dhe më tej në Viminacium, në brigjet e Danubit, duke përfunduar në Kostandinopojë (Stamboll). Në vijim ndiqte trasenë jugore deri në Naissus (Nishi i sotëm) dhe orientohej drejt Serdikës (Sofja), Filipolisit (Plovdiv) dhe Adrianopolisit (Edirne), ku pikej me një degë anësore të rrugës "Egnatia", me zanafillë qytetin e Cipsalas. Për një përshkrim të rrugëve antike të Ballkanit, shih : Fabrizio VANNI - *Le vie terrestri dei Balcani - Alcuni indizi di continuità nel tempo*; Në: Renato STOPANI & Fabrizio VANNI (a cura di) -

La via Diagonalis: itinerario terrestre per Gerusalemme, Rivista "De Strata Francigena" n. XIV/1, Centro Studi Romei, Firenze 2006 ; sikundër dhe : Anna AVRAMEA - *Land and Sea Communications, Fourth-Fifteenth Centuries*, Në: Angeliki E. LAIOU (Ed.) - *The Economic History of Byzantium: From the Seventh through the Fifteenth Century*, Vol. 39, Dumbarton Oaks, Washington DC, 2002.

24. Teksti i Strabonit i referohet në mënyrë të hapur një teksti tjetër më të vjetër dhe të panjohur të Polibit († v. 118 p.e.s), që lë të kuptohet se rruga "Egnatia" ishte vënë në funksionim pas nënshtrimit të Mbretërisë Maqedonase të Perseut nga ana e romakëve, pra, mes viteve 168 - 120 p.e.s. Shih: Michele FASOLO- *La Via Egnatia (I) : Da Apollonia e Dyrrachium ad Herakleia Lynkestidos*, Istituto Grafico Editoriale Romano, 2nd ed., Roma, 2005.

25. Për shumë kohë mbizotëronte mendimi se emri i kësaj rruge vinte nga qyteza-port *Gnathia* (ose Egnatia), e cila gjendej në bregdetin italian, në krahinën e Puljes, diku pranë Barit dhe prej andej niseshin anijet drejt Apolonisë ose Dyrrakiumit. Por zbulimi i një guri miliar pranë Selanikut në vitin 1974 nxori në dritë mbishkrimin dhe dedikimin ndaj Cn. Egnatius. Shih: Paul COLLART - *Une réfection de la «Via Egnatia» sous Trajan*. Në: Bulletin de correspondance hellénique. Volume 59, 1935.

26. Lidhur me një përshkrim të hollësishëm të rrugës "Egnatia", si dhe të segmenteve të saj, shih : Michele FASOLO - *La Via Egnatia (I) : Da Apollonia e Dyrrachium ad Herakleia Lynkestidos*, Istituto Grafico Editoriale Romano, 2nd ed., Roma 2005 (cituar më lart); sikundër dhe : Afrim HOTI & Damianos KOMATAS - *Via Egnatia: The Dyrrachion- Philippi Itinerary (Start to XI Century)*, 2nd International Conference of Balkan Historical Studies "Kavala and the Balkans -Kavala and the Aegean sea", September 2005; së fundi shih : Arja KARIVIERI - *Creating Contacts. Trade and Exchange along the Via Egnatia from the Roman to the Early Byzantine Period*, Bollettino di Archeologia on line I 2010/ Volume speciale C/C11/3.

27. Jacques ANCEL - *Peuples et nations des Balkans*, éd. de C. T. H. S, Paris, 1930 (rééd. 1992) (përmendur më lart).

28. Fernand BRAUDEL - *La Méditerranée et le Monde Méditerranéen à l'époque de Philippe II*, Vol I, Éd. Armand Colin, Paris, 1986.

29. Gabriel LOUIS-JARAY - *Au jeune Royaume d'Albanie (Ce qu'il a été - Ce qu'il est)*, Hachette et Cie, Paris, 1914.

30. Formulimi, apo studimi i historisë njerëzore si ndërthurje dhe implikim i tre kohëve me frekuenca të ndryshme (treshja : *mjedis gjeografik (strukturë) -qytetërim (konjunkturë) - individ (ngjarje)*) është një nga kontributet madhore të Shkollës historike franceze e ashtuquajtur e *Analeve*. Shih për më tepër : Fernand BRAUDEL - *Histoire et Sciences sociales : La longue durée*. Në: Annales. Économies, Sociétés, Civilisations, 13^e année, N. 4, 1958 ; Fernand BRAUDEL - *Grammaire des civilisations*, Arthaud, Paris 1987 ; sikundër dhe : Gérard NOIRIEL - *Comment on récrit l'histoire*. Les usages du temps dans les *Écrits sur l'histoire* de Fernand Braudel, Revue d'histoire du XIX^e siècle, nr. 25, 2002.

31. Paul RICOEUR - *Le retour de l'Événement*. Në: Mélanges de l'Ecole française de Rome. Italie et Méditerranée T. 104, N°1. 1992.

32. Reinhart KOSELLECK - *Vergangene Zukunft. Zur Semantik geschichtlicher Zeiten*, Suhrkamp Insel, Francfort 1979 - Mbi analizën e konceptit dhe referencat e sakta, shih: Paul RICOEUR - *Temps et récit III*, Le Seuil, Points Essais, Paris, 1991.

33. Mes të tjerësh, shih: Jacques BOULOGNE - *Espaces et peuples septentrionaux dans les représentations mythiques des Grecs de l'Antiquité*, Revue du Nord, 2005/2, n° 360-361; sikundër dhe: Christiane VILLAIN-GANDOSSI - *La genèse des stéréotypes dans les jeux de l'identité/alterité Nord-Sud*, Hermès, La Revue, 2001/2 n° 30.

34. Lidhur me konceptin etnogeografik gjatë Lashtësisë dhe Mesjetës si dhe mbi kufijtë e botës së banuar të asokohe, shih: Christian JACOB - *La diffusion du savoir géographique en Grèce ancienne*, Géographie et cultures, Nr 1, 1992 , Delphine ACOLAT - *Mers, montagnes et*

déserts des confins de la terre connue : imaginaire de l'infranchissable et savoirs géographiques, Caesarodunum Journal, XL-XLI, 2011-2012.; sikundër dhe : Evelyn EDSON - *Mapping Time and Space: How Medieval Mapmakers Viewed Their World*, The British Library Studies in Map History, V. 1, London, 1997.

35. Me anë të këtij emri arabët përshkruanin atë tokë të largët që shtrihet në horizontin e pafund: ishujt e Egjeut ose Rodin dhe Qipron. Ndoshta bëhet fjalë për variantin më të pranueshëm nga gjithë të tjerët tek mundohen të shpjegojnë origjinën e emrit “Europë”. Sidoqoftë, bëmat e Zeusit të grekëve ishin edhe më trimërore: ai e rrëmbeu të renë Europa, vajzën e fenikasit Agenor, për ta çuar në Kretë dhe për ta përdhunuar. Si pasojë e kësaj dashurie të pamundur doli Minosi i tmerrshëm. Pra, Europa e helenëve paskish ardhur nga Azia dhe për më tepër, ajo ishte e zezë!

Përtej mitologjisë, Hekateu i Miletit - “*gjyshi i gjeografisë*” dhe ndjekësi i tij, Herodoti i Halikarnasit - “*babai i historisë*”, kishin bindjen se Europa ishte e banuar - përveç grekëve - edhe nga iberët, keltët dhe skitët, ndërkohë që Azia e tyre përmbante: Libinë, Etiopinë, Arabinë, Asirinë, Persinë dhe Indinë. Në këtë mënyrë kuptohet se boshti i tyre Europë - Azi i përgjigjet më tepër boshtit Veri - Jug sesa Perëndim - Lindje. Romakët ishin gjithashtu gjeografë mjaft të zot dhe njëkohësisht po aq konfuzë në lidhje me këtë çështje: që në shekullin e parë p.e.s., Varro, në veprën *De Linguae Latinæ* me 15 vëllime, sugjeron se “*toka është e ndarë nëpërmjet viseve të qiellit në Azi dhe Europë. Azia shtrihet në të vërtetë drejt jugut dhe Austerit, Europa drejt veriut dhe Akuilonit*”. Shih: VARRO - *On the Latin Language* (Vol. I-II), William Heinemann Ltd, London, 1938.

36. Shih mes të tjerash: Aurel PLASARI -*Orienti apo Hija nga Oksidenti?*; Në: <https://www.academia.edu/9153808/>; Predrag MATVEJEVITCH - *Contradictions balkaniques*, Lettre Internationale, n° 3, Paris, septembre 2000; Vesna GOLDSWORTHY - *Invention and In(ter)vention: The Rhetoric of Balkanisation*. Në : Dusan BJELIC & Obrad SAVIC (Eds.) - *Balkan as Metaphor between Globalisation and Fragmentation*. the MIT Press, Massachusetts 2002; Alexander VEZENKOV - *History against Geography: Should We Always Think of the Balkans as Part of Europe?* Në: Alice MACLACHLAN & Ingvald TORSSEN (Eds.) - *History and Judgment*, Vienna: IWM Junior Visiting Fellows' Conferences, Vol. 21 (2006) ; Milica BAKIC-HAYDEN - *Nesting Orientalisms: The Case of Former Yugoslavia*, Slavic Review, Vol. 54, No. 4 (Winter, 1995); Marina ANTIC - *The Balkans and The Other Heading: Identity and Identification on the Margins of Europe*, spacesofidentity 6.2 (2006).

VALLET E KOHËS

KOHA E PARË

NË TERRIN E ANTIKITETIT

MES MITIT DHE REALITETIT, nga tejlashtësia deri në vitin 285 e.s.

*“... Historia nuk ka as fillim, as fund.
Duke u nisur nga përvoja, ne zgjedhim
arbitrarisht një pikënisje,
dhe, nga kjo pikë, këqyrim
qoftë prapa, qoftë përpara...”*

Graham GREENE, “La Fin d’une Liaison”



Cilët qenë pararendësit e shqiptarëve të sotëm?

Kjo është një pyetje e natyrshme për dikë, që e magjeps fisnikëria dhe lashtësia e origjinës. Është një kureshtje e thjeshtë për një tjetër. Sidoqoftë, mbetet një pyetje e shtruar dhe e rishtruar pareshtur, nga momenti që ky popull u shfaq si aktor i skenës ballkanike dhe europiane.

Ç’është e drejta, kjo origjinë fshihet nën një shtresë të trashë misteri, me gjithë numrin e madh të specialistëve (arkeologë, historianë, antropologë apo epigrafistë) dhe të studiuesve të tjerë që janë përkulur mbi këtë çështje. Rrënjët janë kërkuar gjithandej, në Europë edhe më tej, sipas bindjeve apo imagjinatës së kërkuesve të cilët kanë shfrytëzuar elementë të gjuhës, të zbulimeve gjatë gërmimeve arkeologjike dhe së fundi, elemente të aspekteve të gjalla të kulturës materiale dhe jomateriale.

Në funksion të shkallës së përparimit të njohjes, sipas nivelit të seriozitetit të kërkuesve, dhe motivesh të tjera, të ndryshme nga kërkimi shkencor, është mendësuar shkallë-shkallë se këta pararendës kanë qenë të afërt me

pellazgët, me etruskët, me trakët apo të tjerë getë, për të mos thënë dakë, përpara sesa të arrihej në pohimin që populli i sotëm shqiptar gjendet në rrugëzimin historik të ilirëve të vjetër.

Çka nënkupton ky rrugëzim: prejardhje mes përzierjes njerëzore, apo trashëgimi gjenetike? Vijimësi birësore brezash, apo shtresëzim kulturash dhe traditash?

Çështja e tejkalon ndjeshëm kuadrin lokal dhe, dashur pa dashur, përgjigjja imiton shembullin e grekëve të cilët pretendojnë se janë pasardhësit e helenëve të lashtë, i përqaset rastit të italianëve që mburren me gjakun e tyre romak, apo së fundi, ndjek modelin e francezëve, të cilët betohen se stërgjyshërit e tyre kanë qenë galët.

Veçse, edhe në rastin kur arsyeja e ftohtë i kundërshton ndjenjat dhe i shpërfill emocionet, ajo detyrohet të ndjekë një sërë arsyetimesh tashmë logjike, të respektojë njëfarë “*standardi*”: vlerësim i kujtesës dokumentare historike; njohje e natyrës të veçantë të gjuhës; hulumtim i traditave, zakoneve dhe dokeve karakteristike; marrje parasysh e një vargu të gjatë veçorish dhe dallimesh që përbëjnë atë lëndë të mistershme të quajtur “*shpirti i popullit*”, fytyrën e tij të papërsëritshme dhe, ç’është më e rëndësishmja, të pangjashme me popujt e tjerë, fqinjë ose jofqinjë, pra, gjykim i një togu të dhënash vështirësisht të interpretueshme që mes të tjerash, sugjerojnë shtegun e vijimësisë njerëzore të vendbanimit.

Përfundimisht, cilët qenë këta Ilirë?

Një grup i lashtë popujsh, një nga më të vjetrit e Ballkanit, fillimisht fqinj dhe konkurrent i helenëve apo i maqedonasve dhe, më tej, kundërshtar i romakëve. Kostelacioni njerëzor me etiketën e sotme ilire, i përbërë nga klane, fise dhe popullata, shtrihej në një pjesë të tërë të Gadishullit Ballkanik, në zonën e tij përëndimore dhe veriperëndimore, që laget kryesisht nga deti Adriatik dhe Joni Vënor. Me kohë, një rrip i ngushtë bregdetar mori ngjyrat e qytetërimit grek, falë fuqisë së drahmeve të tregtarëve, ndërsa në brendësi, elementi mbizotërues i shoqërisë ilire, mbeti ekonomia blegtorale, bujqësore dhe detare e njerëzve të lirë, një ekonomi e derdhur në kallëpin e “*shtetit territorial*”. Ilirët, luftëtarë të çmuar dhe lundëtarë të guximshëm, krijuan formacionet e tyre shtetërore.

Gjatë shekujve III dhe II p.e.s. Roma ndërmoi një seri luftërash kundër ilirëve. Nënshtrimi i Ilirisë - *Ilirikum* - po ashtu edhe ndërfitja e administratës dhe e kulturës romake, falë forcës së shpatës së legjioneve, kushtëzuan të ardhmen e kësaj pjese të Ballkanit, një e ardhme pandreqshmërisht e lidhur me fatin e Perandorisë Romake për shekuj të tërë.

Të parët

Deri vonë, sinteza historike vendase i përqs gjurmët e para të pranisë njerëzore të zbuluara në viset e sotme shqiptare me *paleolitin e mesëm*ⁱ (rreth 120.000 deri 40.000 vjet më parë). Dëshmitë e gjetura janë fragmentare dhe të ndërthorta, prodhime të dorës së njeriut dhe karakteristike të asaj periudhe. E tillë është p.sh., shpella e Xarrës apo ajo e Kërçmoit pranë Sarandës, sikundër dhe shpella e Gajtanit pranë Shkodrës, ku janë gjetur vegla pune prej guri të latuar dhe stralli, të punuara trashë. Vegla të tjera, prerëse apo gërryese, thika prej stralli, por të rrahura mjaft mirë, ashtu si dhe instrumente prej kocke, i përkasin një periudhe më të vonshme, të ashtuquajturit *paleolit i epërm* (40.000 deri 8.000 vjet p.e.s). Kjo periudhë përfaqësohet me një seri stacionesh paleoarkeologjike: në Dajt, pranë Tiranës, në Xarrë (II) ose Shën Marinë të Sarandës, në Kryegjatë dhe përfundimisht në Gajtan (III)¹.

Fundi i kulturës së gjuetisë dhe i mbledhjes së frutave, si dhe shfaqja e bujqve dhe e kafshërritësve të parë në territorin e sotëm shqiptar diku aty nga fillimi i *neolitit të hershëm*, ka lënë gjurmë të dukshme në zonat lindore të vendit: Vlushë (Skrapar), Podgorie dhe Vashtëmi (Korçë), Kolsh (Kukës). Mosha e tyre vlerësohet të jetë e mijëvjeçarit VII p.e.s. Pa asnjë dyshim, përfaqësuesit më të pasur dhe më të denjë të periudhës së *neolitit të mesëm* mbeten: stacioni i Cakranit bashkë me atë të Dunavecit dhe të Sovjanit, sikundër edhe stacioni i Maliqit dhe ai i Kamnikut (Kolonjë), që e përfaqësojnë po aq denjësisht *neolitin e vonë*.

Vendbanimet e gjetura në fushën e sotme të Korçës (Dunavec, Sovjan dhe Maliq) janë të tipit *palafit*: banesa të ndërtuara mbi hunj. Gjurmët e jetës në to tregojnë për një vijimësi disa qindra, në mos, mijërvjeçare. Datimet më të hershme shkojnë deri në mijëvjeçarin V p.e.s. duke u nisur nga një grumbull objektësh që dëshmojnë njëherësh mbi vazhdimësinë e aktiviteteve tradicionale si: gjuetia dhe peshkimi, praktika e bujqësisë dhe e rritjes së kafshëve, krahasimisht me shfaqjen e aktivitete të reja siç qe artizanati (prodhimi i enëve prej balte, thurja dhe endja e fibrave). Gërmimet paleoarkeologjike kanë nxjerrë në sipërfaqe sëpata dhe çekanë prej guri të

ⁱ *Paleolit* (nga greqishtja: *palaïos* - i vjetër dhe *lithos* - gur), shkallë kohore e bazuar mbi shfaqjen e Njeriut dhe aktivitetin e tij të parë teknologjik të prodhimit të veglave me bazë gurin. Kjo shkallë ndahet në tri periudha: *i poshtëm* (- 3 milionë - 300.000 vjet), *i mesëm* (- 300.000 - 30.000 vjet) dhe *i epërm* (-30.000 - 12.000 vjet). Krahas saj dhe paralelisht me të përdoret një shkallë e dytë kohore shumë më e gjerë, e bazuar në gjeologjinë e formimit dhe të zhvillimit të shkëmbinjve dhe kontinenteve, ku periudhat e mësipërme renditen brenda *epokës së pleistocenit*. Në këtë mënyrë, kur flitet për periodizimin kohor të gjetjeve paleoarkeologjike mund të hasen referenca në lidhje me njërën apo tjetrën shkallë.


lëmuar, shetër prej briri drerësh, gjilpëra kocke, fuzhnja dhe pesha rrjetash, gjithashtu edhe pjesë enësh prej balte, mes mbetjesh farërash drithi të karbonizuara.

Paralelisht me këtë formë banese kolektive, banorët e neolitit vazhdonin të jetonin nëpër shpella (Velçë, Tren, Blaz - Mat ose Konispol), ndërsa dinin të ndërtonin edhe kasolle gjysmë të nëndheshme (Cakran - Fier) ose prej druri të mbështetur mbi truall, në tarracat lumore (Maliq, Kamnik - Kolonjë, Kolsh), të cilat zakonisht kishin një formë eliptike ose qenë me qoshe të rrumbullakosura. Gjatë *neolitit të mesëm* (sipas gjasave, gjatë mijëvjeçarit IV p.e.s.) u shfaq një *artefakt* i ri, karakteristika më e shënuar e të cilit qe prodhimi i poçerisë së zbukuruar. Duke përdorur teknika të ngjashme me ato të zbuluarat në pellgjet fqinje: në Maqedoni (Pelagoni), Thesali (Dhimini), Moravë së Jugut², artizani - artist i Cakranit apo i Maliqit, apo edhe ai i Dunavecit prodhonte enë të trasha balte dhe të një cilësie të rëndomtë, me ngjyrë të kuqe të thellë ose kafe në të zezë, të zbukuruara me motive të ndryshme gjeometrike.

Prodhimtaria e poçarëve lokalë (juglindje dhe verilindje) e shoqëroi pothuaj të gjithë periudhën neolite (të hershme, të mesme dhe të vonë). Me kohë, ajo përfshiu dhe përshtati teknika gjithmonë e më të zhvilluara, që ndikuan në formën e objekteve, në ngjizjen, pjekjen (e lëmuar, barbotinë, impreso), në lëndën e parë dhe veçanërisht në zbukurimin e tyre (ngjyrat, vizatimet, motivet gjeometrike, relievin dhe ngulitjet). Objekte të tjera, shpesh të gjetura rastësisht, por që i përkasin *neolitit të vonë* dhe *eneolitit* (periudhës kalimtare drejt përdorimit të bakrit) janë edhe sëpatat prej guri të lëmuara dhe të shpuara, të cilat janë gjetur në Gruemirë (Shkodër), Shijak (Durrës), Ziçisht (Korçë), Finiq (Delvinë), Nepravishtë (Gjirokastrë).

Fillimi i periudhës së punimit dhe të përdorimit të metaleve, siç është rasti i bakrit, dëshmohet nga dhjetëra vendbanime, të gjetura gjithandej nëpër territorin e vendit. Shfaqjet kryesore vijnë nga gërmimet e bëra në Maliq, Tren dhe Burimas (Korçë), Bënjë (Përmet), Katundas (Berat), sikundër edhe në Nezir (Mat), Gradec (Dibër), Gajtan (Shkodër) dhe Dajç (Kukës). Gjetjet kanë të bëjnë me disa objekte trashanike në bakër (dalta, biza apo grepa peshkimi), mes objekteve të tjera prej guri të lëmuar, prej kocke, briri apo argjile të pjekur. Një interes të veçantë paraqesin edhe figurinat antropomorfe, si edhe enët prej balte, njëngjyrëshe në gri ose në të zezë, format e të cilave me kohë u bënë gjithmonë e më të larmishme. Në vijim, edhe praktikatat lokale të varrimit u bënë fort të ngjashme me ato të rrethqarkut mesdhetar të epokës: trupi i të vdekurit, i shtrirë apo kruspull, vendosej në një gropë të thjeshtë pranë vendbanimit, i pashoqëruar nga objekte mortore.

Një numër mjaft i madh stacionesh dhe pikash arkeologjike të shpërndara në territorin kombëtar, dëshmon për futjen e një materiali të ri - bronzit. Këto



**Gjurmët kryesore të parahistorisë në Shqipëri
(paleoliti, neoliti, eneoliti dhe periudha e bronzit)**
[Sipas një ideje të Frano PRENDIT - *The Prehistory of Albania*]

gjurmë janë të lokalizuara në një rajon të gjerë jugor që nga Korça deri në Sarandë, duke kaluar nëpër Përmet dhe Gjirokastrë, në lidhje të dukshme në rrugë detare me zonën ishullore joniane apo tokësore me rajonet kontinentale greke të llojit mikenas.³ Ato shfaqen gjithashtu në rajonin verior: në Shkodër, Mat dhe Kukës, ku janë gjetur sèpata të shumta, shpata dhe maja shigjetash në bronz, me origjinë ose me ndikime të qarta të rajoneve të Egjeut.

Pa dyshim, vendbanimi më përfaqësues i fillimit të kësaj epoke, i cili realizon njëkohësisht edhe lidhjen organike me atë të mëparshme, është Maliqi (III). Duhet theksuar se qeramika e periudhës së bronzit të hershëm⁴ në përgjithësi ishte ndryshe nga ajo e mëparshme, e krijuar prej traditës lokale, që sillte një shumëllojshmëri formash, ngjyrash - thjesht përsosuri të veçantë. Duke u bërë më e rëndomtë, për të mos thënë më primitive, qeramika përfitoi forma të reja të lidhura me përdorimet e saj gjithnjë e më të zakonshme në jetën e përditshme apo në ceremonitë e kultit; këtu mund të përmenden vegjëet e thjeshta ose të shumëfishta, figurinat antropomorfe dhe zoomorfe, si dhe zbukurimet me breza lineare (shirita), që ishin edhe zbukurimet më të shpeshta.

Fakti se në nivelin e Maliqit III janë gjetur materiale që u përkasin themeleve autoktone të mëparshme të përziera në një mënyrë të papritur dhe të befasishme me sasi të mëdha të një materiali të ri qeramike, tregon se kemi të bëjmë me shfaqjen e një elementi të ri etnik, i cili depërtoi në zonën e juglindjes së Shqipërisë rreth fundit të periudhës së eneolitikut apo fillimit të epokës së bronzit dhe që, pa i rrënuar popullatat eneolitike, u përziej me to ose jetoi krahas dhe mes tyre, duke u shkaktuar një sërë ndryshimesh në strukturat ekonomike dhe etnokulturore.⁴

Me kohë, diku aty nga bronzi i mesëm dhe, në mënyrë të veçantë, gjatë bronzit të vonë vëmë re se teknika e hasur në Maliq dhe në pellgun e Korçës bëhet më e shkathët, për të mos thënë e përsosur; ka shumëllojshmëri motivesh gjeometrike në prodhimet e poçerisë, që janë më të holla dhe veçanërisht më të ngjyrosura (okër, e kuqe dhe gri, e gjelbër). Në formën e saj “devollite”,⁵ kjo teknikë duket e përhapur në një zonë të gjerë të territorit jugor, madje edhe me ndikim ndaj teknologjisë së poçerisë në rajonet fqinje: Maqedoni, Epir, Thesali.

³ Epoka e bronzit - mënyrë periodizimi e parahistorisë, e mbështetur në shfaqjen e metalurgjisë të bronzit. Bronz i hershëm, i mesëm, i vonë janë etapa të zhvillimit të kësaj teknologjie, të pasqyruara në nivelin e përsosjes dhe të përdorimit të objekteve prej bronzi. Harku kohor përkatës mbetet objekt diskutimi mes paleoarkeologëve dhe varet nga zona gjeografike. Kështu, Ballkani Lindor dhe pellgu i detit Egje përqaset me zonën e Azisë së Vogël (2700-1900 p.e.s për bronzin e hershëm, 1900-1500 p.e.s. për bronzin e mesëm dhe 1500-1200 p.e.s. për bronzin e vonë). Ballkani Veriperëndimor përqaset me Europën Qendrore (1800-1500 p.e.s për bronzin e hershëm, 1500-1300 p.e.s. për bronzin e mesëm dhe rreth 1200-800 p.e.s. për bronzin e vonë). Shih: M. Garasanin dhe M. Gimbutas (bibliografi).

Tumat e Pazhokut (Elbasan), Vajzës (Vlorë), Piskovës (Përmet) ose të Bajkajt dhe Vodhinës (Sarandë), që i përkasin periudhës së bronzit të mesëm (1.800-1.500 vjet p.e.s), përmbajnë armë, vegla pune dhe objekte metalike arti, të punuara hollë dhe mjaft të zbukuruara. Gjithashtu nga tuma të tjera si: tumat e Gajtani (Shkodër), e rajonit të Kukësit apo Matit vijnë elemente të tjera *ideosinkretike lokale* të periudhës së bronzit të vonë (si p.sh., sëpata me një teh, të ashtuquajtura *shkodrane*), duke dëshmuar për një zhvillim të dukshëm të metalurgjisë vendase. Bashkë me to gjenden edhe objekte të tjera të frymëzimit mikenas; por inventari i varreve-tuma, vë në pah një sërë elemente të ndryshme dhe armë, autorësia e të cilave mendohet se u përket qytetërimeve të “*fushave me urna*”, me origjinë nga Panonia dhe Europa Qendrore.

Objektet e para prej hekuri i përkasin shek. XI p.e.s., që, më tej, në shekujt pasardhës (IX) u përhapën masivisht në jug të vendit. Gjatë kësaj periudhe, një varg vendbanimesh ruajti karakteristikat e veta të epokës së neolitit (Maliq, Podgorie, Tren), ndërkohë u ngritën të tjera, të cilat u fortifikuan në lartësi (Gajtan). Njëherësh me zhvillimin e teknikave të reja ndërtuese, u përdorën edhe praktika të reja për varrimet: gropat e thjeshta filluan të “konkurroheshin” gjerësisht nga varret-tuma, shpesh monumentale, por aty-këtu janë gjetur edhe praktika të djegies dhe ruajtjes së hirit në urna, që vënë në pah rëndësinë e riteve të varrimit të të vdekurve, si dhe futjen e teknikave të reja, shenjë e pagabueshme e lindjes së një kulture të re.

* * *

Nën dritën e njohjes së sotme të procesit të zhvillimit të Njeriut dhe në mungesë të ndjeshme të elementeve fosile njerëzore të asaj kohe (eshtra, dhëmbë, kafa apo pjesë kockore) për të pohuar pikërisht të kundërtën, detyrohemi të pranojmë se ky vend paraqitet me moshë “*të re*”. Për krahasim, gjurmët e para të aktivitetit njerëzor të zbuluara në kontinentin europian, datojnë mbi 1.5 milionë vjet, për të mos thënë 2 milionë, dhe i takojnë *Homo Erectus*. Saga njerëzore europiane dëshmon për një popullsi “*homogjene, të vazhdueshme dhe endemike*”⁶ fillimisht *Erectus* ose më mirë *protoparaneandertale*, e konkretizuar nga fosili i parë i njohur, me moshë 700.000-vjeçare (Heidelberg - Gjermani); më pas *paraneandertale*, me moshë më të re rreth 450.000-vjeçare (Tautavel - Francë apo Petralona - Greqi) dhe, së fundi, *Homo Neandertalensis* (mes të tjerë shembujsh, Neandertal - Gjermani). Kështu, 120.000 vjet më parë e këtij banorët primitivë të hapësirës së sotme shqiptare, si dhe popullsia protohistorike e këtyre territoreve duhet të jetë po ajo e vendeve të tjera fqinje ose e harkut

verior të Mesdheut: popullsi të shpërndara *neandertale* - banorë të shpellave, që patën ditur të zhvillonin industri të formës *musteriane*ⁱⁱⁱ në kushtet e klimës së ashpër deri edhe akullnajore europiane të asaj kohe.⁷

Diku gjatë *paleolitit të mesëm* (40.000-35.000 vjet p.e.s), duke përfutur nga një ngrohje e motit mes dy periudhave të njëpasnjëshme akullnajore (*Würm II* dhe *Würm III*), në Europë u shfaq një popullsi e re - *Homo Sapiens Sapiens* - e menduar me origjinë nga Azia e Vogël, ku kish zënë rrënjë dhe qe përshtatur prej thuajse 100.000 vjetësh.⁸ Shkallë-shkallë ky njeri modern, i njohur me emrin “*njeriu i Kromanjonit*”, zhvendosi dhe zëvendësoi Neandertalasin, gjurmët e fundit të të cilit humbën gjatë paleolitit të epërm.

Cilat janë arsyet e një zhdukjeje të tillë? Ndoshta për shkak të ndonjë epidemie sëmundjesh vdekjeprurëse; nga zhdukja e llojeve të kafshëve që përbënin gjahun e tij të preferuar; për arsye të rënies së numrit të lindjeve; nga mospërshtatja me ngrohjen e theksuar të klimës apo mbase edhe nga një gjenocid shfarosës i të vjetrit nga më i riu...

Por, pavarësisht nga këto hipoteza,

*fakti se këto dy lloje u vunë në konkurrencë lidhur me mbulimin e territorit dhe shfrytëzimin e burimeve materiale, bëri që aftësia më e kufizuar e Neandertalit për t’iu përgjigjur situatës së re - ajo teknologjike në radhë të parë - çoi drejt zhdukjes, ndoshta progresive, por, sidoqoftë, të pashmangshme.*⁹

Kromanjonët tanë të paleolitit të mesëm ishin gjuetarë të shkathët dhe peshkatarë të zotë. I karakterizonte një progres teknik dhe dinin t’i shfrytëzonin me mjeshtëri veglat e strallit të gdhendura mirë, si edhe bririn apo kockën e drerit, sipas shembullit të *orinjaksienëve* dhe *magdalenianëve*^{iv}. Veçse, në dallim me sivëllezërit e tyre të Europës Perëndimore dhe Qendrore, rishtarët

ⁱⁱⁱ E quajtur kështu për hir të shpellës së Mustierit në Dordonjë (Francë), ku njeriu parasapiens i shpellave (-100.000 deri -36.000 vjet), i ashtuquajtur “*njeriu i Neandertalit*”, kish zhvilluar teknikën e veglave prej stralli të latuar trashë, të mprehura me anë të goditjes me një gur tjetër, herë-herë edhe me teh të dukshëm. Karakteristikat trupore të njeriut të atëhershëm qenë mbresëlënëse: skelet masiv, muskulaturë e fuqishme, gjymtyrë pak a shumë të shkurtra dhe tipare të një fytyre arkaike: kafkë e madhe (me një vëllim prej 1.700-2.000 cm³), ballë i pjerrët dhe i vogël, hark kockor vetullor i kërcyer, hundë e madhe, fytyrë e gjatë, por pa mollëza, nofull e poshtme e imët.

^{iv} *orinjaksienë, magdalenienë* - popullsi të tipit *kromanjon*, të përshtatura në të gjithë Europën gjatë paleolitikut të epërm (*orinjaksienët* nga 35.000 deri 26.000 vjet p.e.s; *magdalenienë* deri në prag të neolitikut, 8.000 vjet p.e.s.). Ata kishin karakteristika tepër të zhvilluara trupore (kafkë të rrumbullt me vëllim 1.550 deri 1.700 cm³; ballë i madh dhe i kërcyer, fytyrë vezake me mollëza të dala dhe mjekër të formuar mirë, gjymtyrë të gjata) dhe zotëronin teknika mjaft të zhvilluara të prodhimit të veglave të punës (vegla prej stralli të mprehura shumë mirë, objekte të ndryshme prej kocke dreri). Këto popullsi përdornin zjarrin për nevojat e tyre jetësore, shpikën harkun, zbukurorin veglat dhe objektet e tjera të jetës së përditshme dhe ndërkohë organizonin ceremoni simbolike, rrjedhim i të cilave mbeten pikturat murale.

paleolitikë të Ballkanit duket se patën përfituar nga kushtet klimatike fort të favorshme: akullnajat e Europës Veriore nuk zbritën kurrë më poshtë se paraleli 45°, madje edhe në kulmin e të ftohtit kontinental (nga 75.000 deri 13.000 vjet p.e.s.). Si pasojë, klima e Ballkanit, veçanërisht në zonat jugore, juglindore dhe jugperëndimore, nuk i njohu kushtet e shkretëtirës së akullt arktike - permafrostin dhe tundrën - duke ruajtur karakteristikat e një stepe pjesërisht të pyllëzuar, me një faunë të larmishme dhe kafshë të trasha gjahu si: demi, bizoni, dreri i kuq apo gomari i egër, por jo mamuthi, rinocerosi me lesh apo rena, karakteristikë të Europës Veriore dhe kontinentale.

Por ndërkohë atyre iu desh ta shndërronin thellësisht mënyrën e jetesës dhe të mësoheshin me ndryshimin e parametrave klimatikë që e karakterizuan kontinentin gjatë ngrohjes pasardhëse globale: rreth 16.000 vjet p.e.s., kur filloi shkrirja e akullnajave kontinentale dhe niveli i detit Adriatik dhe Egeut u rrit mbi 100 metra, vija bregdetare u zhvendos disa dhjetëra kilometra në thellësi të tokës. Si pasojë, njerëzit e asaj kohe u ikën brigjeve të sheshta për t'u vendosur në brendësi të tokës; pra, duke braktisur ndërkohë edhe aktivitetet e tyre: peshkimin, mbledhjen e kërmijve apo guaskave, për t'iu përkushtuar kryekëput zanatit të shtegtarit, në ndjekje të një gjahu të ri (buali i myshkët, kaprolli apo dreri i pyllit, tashmë të ambientuar me masivet e dendura drunore të brendësisë së gadishullit).¹⁰

Është e kuptueshme se, në këto kushte specifike, banorët ballkanikë të paleolitit të epërm nuk zhvilluan të njëjtat teknika përpunuese të veglave, as të njëjtat aktivitete simbolike dhe, aq më pak, as shfaqjet e artit mural, tipike për bashkëkohësit e tyre kontinentalë të “*ngujuar*” për një kohë të gjatë në shpellat e veta mbrojtëse. Pikërisht mungesa e nevojës së ngujimit i shtyu të parët që t'i përkustoheshin zhvillimit të aktiviteteve ndihmëse (kërkimit të materialeve më të përshtatshme për vegla), krijimit të artefakteve dhe organizimit hapësinor të mjedisit të banimit; solli braktisjen e parakohshme të shpellave dhe ndërtimin e strehimeve të përkohshme apo të qëndrueshme (banesave), zakonisht pranë ujërave. Përfundimisht, ndërthurja e kushteve të veçanta natyrore dhe klimatike bëri që zhvillimi njerëzor i viseve ballkanike dhe, si rrjedhim, zhvillimi teknologjik përkatës tregoi karakteristika të një vijimësie të theksuar, të tillë që të zhduket ai “*kufiri tipik ndarës*” në industrinë e gurit mes fundit të paleolitit dhe fillimit të neolitit; gjë që i ka shtyrë studiuesit të pohojnë deri edhe “*mungesën e Mezolitikut*” në Ballkan.

Sipas një gjykimi tashmë të përgjithësuar, jeta prej gjuetari - frutambledhës e këtyre aborigjenëve të skajit të epokës të gurit të vjetër u trondit dhe u ndërpre nga shtrirja graduale e popullatave të reja bujqish dhe kafshërritësish në mijëvjeçarin VII, aty rreth 6.500 vjet p.e.s. Këta të fundit, nëpërmjet mbishkeljes, përzierjes, përthithjes, për të mos thënë asgjësimit të aborigjenëve kromanjonas, u imponuan në një zonë mjaft të gjerë gjeografike.

Mendohet se kjo zonë fillimisht kufizohej në Ballkan dhe në rajonet fqinje danubiane, përpara se të përhapej në të gjithë kontinentin europian ose dhe më tej.

Nga vinin këto popullata të reja? Përse ndodhi kjo dyndje e madhe - e treta sipas radhës, pas asaj të Homo Erectusit dhe të Kromanjonit - në territorin e Europës?

Këto pyetje të vetvetishme janë të parat e një vargu të tërë që do ta shoqërojnë këtë libër deri në faqet e fundit. Ç'është e drejta, këto pyetje do të shërbejnë kryesisht për të renditur dhe sidomos për të krahasuar hipotezat të cilat shpesh mbeten kundërshtuese: ato nuk kanë as ambicien, as edhe mundësinë për të zbuluar *"të vërtetën e pastër"*. Është fjala për një metodë - një mjet hulumtimi - për të zgjeruar qerthullin e kërkimeve, përpara sesa të vihet gishti mbi një zgjedhje. Sidoqoftë, kjo metodë lejon të ndiqen dredhat e arsyetimeve të stërholluara dhe, më tej, mundëson heqjen e asaj vije të drejtë të fundit që çon drejt përfundimit.

Për sa u përket bujqve, kafshërritësve tanë të neolitit, pothuaj të gjithë studiuesit dhe kërkuesit (historianë, gjuhëtarë, arkeologë apo të tjerë gjeneticienë) lënë të nënkuptohet madje edhe arrijnë të shprehen se qenë ose ardhacakë nga territoret fqinje (Azia e Vogël Lindja e Afërt), ose me origjinë nga vetë rajonet ballkanike. Falë vetive të tyre - gjenetike, morfologjike dhe intelektuale - ata u bënë jo vetëm shpikës të teknikave të reja bujqësore, por njëkohësisht edhe krijues të *"kulturës danubiane"*, e quajtur ndryshe edhe *"kultura e Europës së vjetër"*, kjo *"bashkësi e gjerë e cila e gjeti burimin e vet gjatë neolitizimit të Ballkanit (në mijëvjeçarin VII p.e.s.) dhe vazhdoi përmes tërë periudhës kalkolitike deri në epokën e bronzit"*¹¹. Meqenëse kosheres iu gjet pak a shumë origjina, diskutimi përqendrohet mbi motivet e roitjes së kësaj bashkësie, mbi shkaqet e shpërndarjes në të gjithë Gadishullin Europian e popullatave që shprehin një varg treguesish të përbashkët të natyrës materiale, kulturore, gjuhësore.

Një grusht kërkuesish ka përpunuar Teorinë e ndërfutjes neolitike (TNN), ndryshe *"anatoliane"*, sipas së cilës, të gjithë fermerët e parë të Europës kanë dalë nga vatra e tyre e origjinës, diku në pllajtat e Anolisë, gjatë mijëvjeçarit VII p.e.s. Po sipas tyre, kjo shpërndarje njerëzore është e pandalshme, qe pasojë e drejtpërdrejtë e mënyrës së re të prodhimit bujqësor që shkaktoi një rritje të vazhdueshme të popullatës. Me të arritur ngopjen e saj nga pikëpamja numerike - një proces që kërkon disa breza, kjo e fundit e kërkon zgjidhjen e problemit të saj demografik në mënyrë krejt të natyrshme nëpërmjet zhvendosjes progresive. Duke prekur fillimisht Egjeun dhe brigjet lindore të Ballkanit, më tej edhe thellësitë e gadishullit rreth viteve 6.500-6.000 p.e.s., bujqve neolitikë iu desh gati një mijëvjeçar për të arritur në viset e Gjermanisë së sotme dhe një mijëvjeçar tjetër për të